FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 75

Tiranë – E hënë, 27 maj 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11188, datë 17.5.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5667
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 20.5.2019	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Lezhës...	5667
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 22.5.2019	Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi.....	5667
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 22.5.2019	Për lirim nga detyra.....	5671
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 331, datë 22.5.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 360, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave'".....	5671
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 22.5.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 524, datë 15.8.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave, për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave"...	5672
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 333, datë 22.5.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim i sheshit te lagjja 'Lugina', Bashkia Shijak".....	5685
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 22.5.2019	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Beratit...	5686
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 22.5.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 294, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Këshillit të Investimeve".....	5686
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 336, datë 22.5.2019	Për miratimin e Raportit Vjetor për Ndihmat Shtetërore të vitit 2018....	5687

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 22.5.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 3, datë 9.1.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2019, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)".....	5698
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 22.5.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 787, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen e komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë", të ndryshuar.....	5698
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 2.5.2019	Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve dhe të fondeve buxhetore për institucionet e sistemit të drejtësisë, për vitin 2019.....	5699
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 344, datë 22.5.2019	Për shfuqizimin e vendimit nr. 744, datë 5.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin, në përgjegjësi administrimi, të objektit 'Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave', Tiranë, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit/Universiteti Politeknik i Tiranës, te Ministria e Drejtësisë, për Gjykatën e Lartë", të ndryshuar.....	5700
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 22.5.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar.....	5700
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 22.5.2019	Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private.....	5702
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 22.5.2019	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për bashkëpunim në turizëm.....	5720
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 12, datë 20.5.2019	Për masat për zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore 2019.....	5722
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 402, datë 14.5.2019	Për procedurat e punësimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike...	5724
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 607, datë 21.5.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Gjirokastër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	5728
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5277/1, datë 22.5.2019	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga e Arbrit"...	5729
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7373, datë 20.5.2019	Për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.....	5732
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Kita Mico.....	5732

DEKRET
Nr. 11188, datë 17.5.2019

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, me propozim edhe të ministrit të Kulturës

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Veton Gani Vula
2. Violeta Iliaz Vula (Ukmata)
3. Vegim Veton Vula
4. Fjolla Veton Vula
5. Pal Lekë Lekaj
6. Gita Gjokë Lekaj (Karricaj)
7. Asdren Pal Lekaj
8. Ema Rexhep Ismaili
9. Zanfina Rexhep Ismaili
10. Gani Rrahman Ademi
11. Vjosa Mustafë Muçaj Ademi (Muçaj)
12. Kelmend Nreca Spaqi
13. Alex Bajram Selimaj (Selimoviq/ Seljimović)
14. Lumnije Viktor Frrokaj
15. Adelina Rexhep Ismaili Krasniqi (Ismaili)
16. Smajl Malush Latifi
17. Fatime Avduraman Latifi (Krasniqi)
18. Nesrete Avdulla Vula (Stavileci)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 326, datë 20.5.2019

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Gjergj Prendi, prefekt i qarkut të Lezhës, lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Gjokë Jaku emërohet prefekt i qarkut të Lezhës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 329, datë 22.5.2019

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS SË BASHKIVE ME AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE TË PRONËSISË MBI KËTO TROJE, PËR EFEKT REGJISTRIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 53, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", të neneve 192 e 193, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim:

a) vendosjen nën një regjim të rregullt juridik të procedurës së ndjekur nga ana e njësive të qeverisjes vendore për kalimin e pronësisë së trojeve të dhëna për ndërtim, për efekt regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme;

b) heqjen e kufizimeve nga regjistri i pasurive të paluajtshme, kur aktet e kalimit të pronësisë janë regjistruar më parë;

c) regjistrimin e akteve të kalimit të pronësisë, në rastet kur ato nuk janë regjistruar më parë;

ç) përfundimin e procedurave të kalimit të pronësisë mbi këto troje nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në rastet kur nuk janë përmbyllur dhe regjistrimin e akteve të kalimit të pronësisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

2. Objekt i këtij vendimi janë tokat e dhëna për qëllime ndërtimi nga bashkitë, ish-komunat dhe ish-këshillat e rretheve (në vijim të quajtura "organe vendore"), pas datës 10.8.1991 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 24/2012, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij"".

3. Kanë të drejtë të përfitojnë nga dispozitat e këtij vendimi subjektet që, sipas rastit,:

a) janë pajisur nga organet vendore me dokumentacion pronësie mbi tokën, pavarësisht mangësive në procedurë. Këto subjekte përfitojnë regjistrimin e dokumentit të pronësisë ose heqjen e kufizimit nga regjistri, pas plotësimit të mangësive, sipas rregullave të këtij vendimi; ose

b) nuk janë pajisur nga organet vendore me dokumentacion pronësie mbi tokën, por për ta është miratuar të paktën vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e truallit për ndërtim, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Në favor të këtyre subjekteve përfundohen procedurat e kalimit të pronësisë dhe kryhet regjistrimi i dokumentacionit të pronësisë dhe/ose heqja e kufizimit nga regjistri, sipas rregullave të këtij vendimi.

4. Bashkia, në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme, është organi që ngarkohet për plotësimin e mangësive të dokumentacionit ose, sipas rastit, për përfundimin e kalimit të pronësisë.

5. Procedurat sipas këtij vendimi nisin me kërkesë të subjektit të interesuar. Kërkesa paraqitet, sipas rastit,:

a) pranë drejtorisë vendore të ASHK-së, kur kërkohet regjistrim i dokumentacionit të pronësisë, heqje e kufizimit nga regjistri ose çdo shërbim tjetër që lidhet me pasurinë e paluajtshme, nëse ajo është regjistruar më parë. Kur drejtoria vendore e ASHK-së konstaton se është i nevojshëm plotësimi i mangësive ose përfundimi i kalimit të pronësisë, ajo njofton bashkinë kompetente për kryerjen e veprimeve përkatëse, sipas procedurave të parashikuara në këtë vendim;

b) pranë bashkisë kompetente, në rastet e parashikuara në pikën 11, të këtij vendimi.

Në rast se bashkia nuk kryen veprimet e nevojshme brenda 3 (tre) muajve, subjekti i interesuar mund të ngrejë padi pranë gjykatës kompetente kundër mosveprimit administrativ.

II. KRITERET E REGJISTRIMIT DHE DISPONIMIT TË LIRË TË PASURISË

6. Kur toka e dhënë për ndërtim nga organet vendore i përket ende përfituesit fillestar të saj, ai mund të kërkojë regjistrimin (nëse nuk është regjistruar më parë) dhe ta disponojë lirisht atë, nëse plotësohen këto kushte:

a) Është miratuar vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

b) Ekziston kontrata apo akti për kalimin e pronësisë mbi tokën, nga organet vendore te përfituesi, i cili duhet të ketë formën:

i. e një akti noterial kur veprimi është kryer pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1994; ose

ii.e një kontrate jonoteriale, ose shkrese të thjeshtë, kur veprimi është kryer para hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1994. Përjashtimisht, kalimet e pronësisë që i përkasin kësaj periudhe konsiderohen të vlefshme edhe në mungesë të kontratës apo të shkresës së thjeshtë, me kusht që të administrohet dokumenti që vërteton pagesën e vlerës së truallit.

c) Është shlyer çmimi i shitjes së tokës (sipas vërtetimit të pagesës), e përcaktuar në aktin e kalimit të pronësisë, sipas vlerës në kohën e miratimit të vendimit të këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim;

ç) Si rregull, të ekzistojë dokumentacioni për ndërtimin e objektit, sipas legjislacionit të kohës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, përveç

procesverbalit të piketimit, i cili nuk është i nevojshëm. Nëse ky dokumentacion nuk ekziston apo është i pamjaftueshëm për regjistrimin e objektit, drejtoria vendore e ASHK-së zbaton rregullat e kreut V, të këtij vendimi, pa penguar procedurat për truallin, sipas dispozitave të tjera të këtij vendimi.

Kur mbi pasurinë nuk gjendet asnjë ndërtim, kryhen procedurat e regjistrimit, të heqjes së kufizimit ose/dhe të përfundimit të kalimit të pronësisë, sipas këtij vendimi, vetëm për tokën. Ky rregull nuk zbatohet në rastet kur për tokën e pazhvilluar me ndërtim ka tituj pronësie të të tretëve (të mbivendosur) të regjistruar më parë.

Kur ka mangësi të dokumenteve të parashikuara më sipër, por për subjektin është miratuar të paktën vendimi i këshillit të organit vendor, për dhënien e tokës për ndërtim, regjistrimi i pronësisë ose heqja e kufizimit mbi tokën nga regjistri, kryhet pasi bashkia të ketë plotësuar mangësitë e dokumentacionit, apo të ketë përfunduar procedurat e kalimit në pronësi, sipas këtij vendimi.

7. Kur përfituesi fillestar i tokës ua ka kaluar të drejtat të tretëve dhe ky veprim juridik është regjistruar përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në regjistrin e pasurive të paluajtshme, të tretët nuk pengohen në disponimin e lirë të pronës, pavarësisht mangësive të formës, procedurës, apo përmbajtjes, që ka në origjinë dokumentacioni i fitimit të pronësisë nga organet vendore. Në të gjitha këto raste (me përjashtim të kalimit me trashëgimi), drejtoria vendore e ASHK-së detyrohet të heqë kufizimin nga regjistri i pasurive të paluajtshme, me paraqitjen e kërkesës nga subjekti i interesuar. Ky rregull nuk zbatohet kur është e pranishme situata e mbivendosjes së titujve, që nuk mund të zgjidhet administrativisht, sipas pikës 15, të këtij vendimi.

III. PROCEDURA PËR PASURITË E REGJISTRUARA

8. Kur toka është e regjistruar dhe subjekti i interesuar paraqet kërkesë për shërbim, drejtoria vendore e ASHK-së verifikon dokumentacionin arkivor të regjistrimit dhe, në varësi të rastit, vepron, si më poshtë vijon:

a) kur rezulton se përmbushen kushtet sipas pikave 6 ose 7, të këtij vendimi, heq kufizimin (nëse ka të tillë) nga regjistri i pasurive të paluajtshme dhe realizon shërbimin e kërkuar; ose

b) kur toka i përket ende përfituesit fillestar të saj dhe konstatohen mangësi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga administrimi i kërkesës, i kërkon bashkisë të vendosë në dispozicion kopje të dokumentacionit që mungon, sipas pikës 6, të këtij vendimi, (sipas rastit: konfirmimin për vendimmarrjen e këshillit të organit vendor, aktin e kalimit të pronësisë, konfirmimin për pagesën e çmimit të tokës apo dokumentacionin për ndërtimin).

9. Në rastin e shkronjës "b", të pikës 8, nëse bashkia konstaton se për pasurinë dokumentacioni është i plotë, i dërgon drejtorisë vendore të ASHK-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga administrimi i kërkesës, kopje të dokumentacionit të kërkuar. Drejtoria vendore e ASHK-së heq kufizimin (nëse ka të tillë) nga regjistri i pasurive të paluajtshme dhe realizon shërbimin e kërkuar nga subjekti i interesuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga administrimi i përgjigjes nga bashkia.

9.1. Nëse bashkia konstaton se për pasurinë dokumentacioni nuk është i plotë, por ekziston të paktën vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim, ajo procedon, sipas rastit,:

a) duke i kërkuar subjektit përfitues të shlyejë pjesën e mbetur të çmimit të shitjes, të përcaktuar në aktin e kalimit të pronësisë; dhe/ose

b) duke thirrur subjektin përfitues për lidhjen e kontratës noteriale për kalimin e pronësisë mbi tokën, nëse ajo nuk është lidhur më parë, pasi të jetë shlyer vlera e plotë e çmimit të shitjes. Çmimi i shitjes do të jetë sipas vlerës së referencës në momentin e miratimit të vendimit të këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim.

Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotësimi i dokumentacionit të mësipërm, bashkia njofton drejtorinë vendore të ASHK-së, duke i përcjellë kopjen përkatëse. Drejtoria vendore e ASHK-së heq kufizimin (nëse ka të tillë) nga regjistri i pasurive të paluajtshme dhe realizon shërbimin e kërkuar nga subjekti i interesuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga administrimi i përgjigjes nga bashkia.

9.2. Nëse pas 3 (tre) muajve nga paraqitja e kërkesës, sipas shkronjës "b", të pikës 8, bashkia nuk i ka kthyer përgjigje as ASHK-së, as nuk ka njoftuar subjektin për plotësimin e dokumentacionit, ky i fundit mund të ngrejë padi

kundër mosveprimit të bashkisë, pranë gjykatës administrative kompetente.

IV. PROCEDURA PËR PASURITË E PAREGJISTRUARA

10. Kur pasuria nuk është e regjistruar, subjekti përfitues, nëse disponon dokumentacionin e plotë të parashikuar në pikën 6, të këtij vendimi, mund t'i kërkojë drejtorisë vendore të ASHK-së regjistrimin e pronësisë.

10.1 Drejtoria vendore e ASHK-së, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës së bashku me dokumentacionin shoqërues, i kërkon bashkisë përkatëse konfirmimin e vërtetësisë/saktësisë së këtij dokumentacioni. Nëse bashkia nuk kthen përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve, kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje dhe drejtoria vendore e ASHK-së vijon me regjistrimin e pronësisë.

10.2 Nëse bashkia është në pamundësi për të verifikuar vërtetësinë, për shkak të mangësive në dokumentacionin e saj arkivor, merret i mirëqenë dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti dhe drejtoria vendore e ASHK-së vijon me regjistrimin e pronësisë.

11. Subjekti që nuk zotëron dokumentacionin e plotë të përcaktuar në pikën 6, të këtij vendimi, por që ka të paktën vendimin e këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim, ka të drejtë t'i paraqesë kërkesë bashkisë përkatëse për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë. Bashkia procedon me plotësimin e dokumentacionit dhe dërgimin e tij për regjistrim njësoj si në pikën 9.1, të këtij vendimi. Drejtoria vendore e ASHK-së, pas administrimit të dokumentacionit nga bashkia, kryen regjistrimin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës për shërbim nga subjekti i interesuar. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur për pasurinë rezulton të ketë tituj pronësie të të tretëve të mbivendosur apo kur ajo është e zënë me ndërtime pa leje të të tretëve.

11.1 Nëse bashkia nuk kryen procedurat për kalimin e pronësisë brenda 3 (tre) muajve nga paraqitja e kërkesës së subjektit, ai mund të ngrejë padi kundër mosveprimit të bashkisë, pranë gjykatës administrative kompetente.

V. RASTET E ZBATIMIT TË PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT

12. Nëse mbi pasurinë gjendet ndërtim, por për të mungon dokumentacioni sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ose është i pamjaftueshëm për regjistrimin e tij, zbatohen procedurat e legalizimit sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.

13. Kur dokumentacioni sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit është i pamjaftueshëm për regjistrimin e objektit dhe në të nuk ka shtesa tej projektit apo ndryshime të funksionit të hapësirave, ndërtimi trajtohet i tëri si "objekt pa leje".

14. Në kuptim të këtij kreu, procedurat e legalizimit zbatohen vetëm për efekt të regjistrimit të ndërtimit dhe subjektet nuk paguajnë detyrim financiar për parcelën ndërtimore sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Në çdo rast, si titull pronësie mbi truallin njihet ai i fituar nga organet vendore, sipas parashikimeve të krerëve të tjerë të këtij vendimi.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

15. Në rastet kur trualli i dhënë nga organet vendore rezulton të jetë i mbivendosur me tituj të tjerë, të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, drejtoria vendore e ASHK-së zbaton dispozitat për korrigjimin e gabimeve në regjistër ose përmirësimin e regjistrit sipas ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", nëse janë të nevojshme. Kur mbivendosja nuk mund të zgjidhet sipas procedurave dhe dispozitave të sipërpërmendura, drejtoria vendore e ASHK-së udhëzon subjektet për zgjidhjen e çështjes në rrugë gjyqësore.

16. Nëse gjatë zbatimit të procedurave sipas këtij vendimi, drejtoria vendore e ASHK-së konstaton se në dokumentacionin e pronësisë së truallit nuk janë të identifikueshëm kufijtë e tij, i kërkon bashkisë të përcjellë planvendosjen e pasurisë, për plotësimin e dokumentacionit të regjistrimit.

17. Në të gjitha rastet kur pronësia mbi truallin e ndërtesës të ngritur sipas legjislacionit të kohës "Për urbanistikën", nuk mund të regjistrohet apo të përfitohet sipas dispozitave të këtij vendimi, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 10270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij".

18. Të ardhurat që do të realizohen sipas pikave 9.1. dhe 11, të këtij vendimi, ndahen sipas mënyrës së mëposhtme:

a) 50% e vlerës i mbetet njësisë së qeverisjes vendore;

b) 50% e vlerës i kalon fondit të kompensimit financiar, të parashikuar në ligjin nr. 133/2015.

19. Ngarkohen bashkitë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 330, datë 22.5.2019

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Ardiana Jaku, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 331, datë 22.5.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 360, DATË 26.4.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15, pika 2, e 94, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rregulloren bashkëlidhur vendimit nr. 360, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në nenin 4, të kreut I, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i) Shkronja "gj" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"gj) Vë në dispozicion të kërkuesve mjetet e informimit dhe shërben dokumentet në përputhje me rregulloren e shfrytëzimit. Orari ditor i punës për nëpunësit dhe punonjësit e sallës së studimit mund të përfshijë edhe ditën e shtunë dhe ndahet sipas turneve të përcaktuara në rregullore, ndërsa, rregullat e tjera për pushimet dhe kohëzgjatjen e punës përcaktohen në legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.".

b) Pas shkronjës "k" shtohen shkronjat "l", "ll" e "m", me këtë përmbajtje:

"l) Kryen blerjen e përqendruar për kutitë dhe dosjet për ruajtje të përhershme në çastin që fondkrijuesit kërkojnë të dorëzojnë dokumentet RHK pranë arkivave jo në veprim. Marrja në dorëzim nga autoritetet kontraktore bëhet vetëm pas verifikimit të parametrave të cilësisë nga punonjësit e specializuar të fushës së kimisë/restaurimit dhe arkivistikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kërkesa për dorëzimin e dokumentacionit nga fondkrijuesit i bëhet menjëherë e ditur Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nga arkivi jo në veprim, së bashku me sasinë e kutive e të dosjeve, të përllogaritura pas kontrollit të kryer nga arkivi jo në veprim, dhe shërben si nisje e procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;

ll) Kryen blerjen e përqendruar për kutitë dhe dosjet për ruajtje të përhershme për institucionet që kanë arkiva jo në veprim, për tipologjinë dhe institucionet e miratuara nga Këshilli i Lartë i Arkivave, sipas shkronjës "f", të nenit 8, të kësaj rregulloreje, si dhe për materialet speciale të restaurimit të letrës. Marrja në dorëzim nga autoritetet kontraktore bëhet vetëm pas verifikimit të parametrave të cilësisë nga punonjësit e specializuar të fushës së kimisë/restaurimit dhe

arkivistikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;

m) Procedura e prokurimit zhvillohet në fund të çdo viti, për vitin pasardhës, në bazë të totalit të sasive dhe fondit limit, të kërkuara për vitin pasardhës nga autoritetet kontraktore, të përcaktuara në shkronjën "ll", të këtij neni, të cilat janë të detyruara t'ia përcjellin Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, së bashku me përllogaritjen e sasisë e të fondit limit të fondkrijuesve, që pritet të dorëzojnë gjatë vitit pasardhës, jo më vonë se data 15 shtator e çdo viti. Çmimi për njësi për përllogaritjen e fondit limit u bëhet i ditur institucioneve të përmendura në këtë shkronjë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, jo më vonë se data 31 gusht e çdo viti, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.".

c) Pas shkronjës "dh", të pikës 5, të nenit 8, të kreut II, shtohen shkronjat "e", "ë" dhe "f", me këtë përmbajtje:

"e) Miraton standardet e kutive, të dosjeve dhe mjeteve kancelarike, që ndikojnë te cilësia dhe jetëgjatësia e dokumentit, të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë;

ë) Miraton standardet e kutive e të dosjeve për ruajtje të përhershme për arkivat jo në veprim dhe për institucionet që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre;

f) Përcakton institucionet dhe tipologjinë e dokumenteve të institucioneve, që janë të detyruara të zbatojnë standardin e shkronjës "ë", të pikës 5, të këtij neni.".

ç) Neni 11, i kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 11

Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" (KDZH)

Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" rregullohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror.".

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 332, datë 22.5.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 524, DATË 15.8.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË FINANCAVE, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 8, pika 3, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 524, datë 15.8.2007, të Këshillit të Ministrave, përmasave të pronës me numër rendor 10, Dega Doganore Berat, i shtohen përmasat e përcaktuara në formularët dhe në planrilevimet që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Lista e inventarit përbëhet nga 2 (dy) fletë dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

INSTITIUCIONI ; DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE (DOGANA BERAT) Identifikoi: **BETINA HYSA**

Bashkia: **Berat**

Supervizoi: **GJYZEMIN KONDAKCI**

Fusha e perdorimit te Prones: **SHERBIM DOGANOR** Aprovoi: ~~AUREL VEIZAJ~~

	A		B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m^2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Kompleksi i ri Doganor Bashkia Berat		Tek ish kombinati i tekstileve		Sherbim doganor	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Tirane	Dogana Berat	
1	8501 A-3 A-4	**19/20**		**Zyre e doganes Ndertese**	Tek ish kombinati i tekstileve	**12 m²**	Administrate	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Tirane	Dogana Berat	
	8501 A-3 A-4	19/10		Shesh			Siperfaqe funksionale	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Tirane	Dogana Berat	
2	8501 A-3 A-4	**19/3**		**Ndertese Garazh Ndertese**	Tek ish kombinati i tekstileve	**5 m²**	Sherbim doganor	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Tirane	Dogana Berat	
	8501 A-3 A-4	19/7		Godine Truall Ndertese			Sherbim doganor	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Tirane	Dogana Berat	
	8501	19/23		Magazina			Ambjent	Drejtoria e	Dogana	

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

	A-3 A-4			Truall Ndertese			ndihmes	Pergjithshme e Doganave Tirane	Berat	
	8501 A-3 A-4	19/351		Ndertese Truall Ndertese			Sherbim doganor	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Tirane	Dogana Berat	
3	**8501** **A-3** **A-4**	**19/25**		**Magazina Mallra** **Sekuestro** **Ndertese**	Tek ish kombinati i tekstileve	**152 m²**	Ambjent ndihmes	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Tirane	Dogana Berat	
	8501 A-3 A-4	19/16		Shesh			Sherbim doganor	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave Tirane	Dogana Berat	
				Siperfaqe totale e prones	Truall Ndertese	6625 m2 1142 m2				

Trualli eshte ne rregull I hipotekuar

Ndertese konform VKM-se Nr. 524 dt. 15/08/2007 eshte hipotekuar 973 m²

Pjesa per tu hipotekuar mbetet ndertese me 169 m².

Plan Rilevimi

I PRONES (SAKTESIM SIPERFAQE)

PERGATITI :

Emri: GJYLZEMINE KONDAKCIU

Licensa Nr:T 0545/1 Data 27/03/2018

Data e Pergatitjes: TETOR 2018

GjyzeminKondakçi
TOPOGRAFE
Nr Lic. T,2, 0545

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale: 8501

Nr.I Pasurise : 19/20 Vol. 29 Fq. 209

Indeksi I Hartes: BR:A-3

Shkalla: 1:500

Adresa e Pasurise: Rruga BERAT

Q/F Lagja "KOMBINATI TEKSTIL"

1KP/G Sh K 1 K Ap NDERTESE.

DOGANA BERAT

Pronari/et



KUFIZIMET

V. 19/10
L. 19/10
J. 19/20,21.
P. 1/290,87.

SIPERFAQA TOTALE NDERTESE = 12 M2 ND.

PRONARI DOGANA BERAT

Emer, Mbiemer, Firma

DOGANA BERAT

PLANIMETRIA E NDERTESES 2K PAS.NR.KAD.19/20

KATI I I-RE GODINA ADMINISTRATIVE

SH 1:100 BERAT



SIPERFAQA NDERTIMORE =12 M2ND.

GjyzeminKondakçi
TOPOGRAFE
Nr Lic. T.Z. 545

Plan Rilevimi

I PRONES (SAKTESIM SIPERFAQE)

PERGATITI :

Emri: GJYLZEMINE KONDAKCIU

Licenca Nr:T 0545/1 Data 27/03/2018

Data e Pergatitjes: TETOR 2018

GjyzeminKondakçi
TOPOGRAFE
Nr Liç. T, Z, 0545

Vula/Firma

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale: 8501

Nr.i Pasurise : 19/3 Vol. 29 Fq. 217

Indeksi i Hartes: BR:A-3

Shkalla: 1:500

Adresa e Pasurise: Qyteti BERAT

O/F Lagja "KOMBINATI TEKSTIL"

1KP/G Sh K 1 K Ap NDERTESE

DOGANA BERAT

Pronesi/et



KUFIZIMET

V. 19/10
L. 19/10
J. 19/10
P. 19/10.

SIPERFAQA TOTALE NDERTESE. = 5 M2 ND.

PRONARI DOGANA BERAT

Emer, Mbiemer, Firma

DOGANA BERAT

PLANIMETRIA E NDERTESES 1K (GARAZH)

PAS.NR.KAD.19/3 KATI I I- RE JASHTE GODINES

SH 1:100 BERAT

SIPERFAQA NDERTIMORE =5M2ND.

Giyzaminkondaki
TOPOGRAFI

Plan Rilevimi

I PRONES (SAKTESIM SIPERFAQE)

PERGATITI :

Emri: GJYLZEMINE KONDAKCIU

Licensa Nr:T 0545/1 Date 27/03/2018

Data e Pergatitjes: TETOR 2018

GjyzeminKondakçi
TOPOGRAFE
Nr Liç. T,Z. 0545

Vula/Firma

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale: 8501

Nr.I Pasurise : 19/25 Vol.20 Fq. 247

Indeksi I Hartes: BR:A-3

Shkalla: 1:500

Adresa e Pasurise: Rruga BERAT

Q/F Lagja "KOMBINATI TEKSTIL"

1KP/G Sh K 1 K Ap NDERTESE

DOGANA BERAT

Pronari/et



KUFIZIMET

V. 19/10
L. 19/10.
J. 19/16
P. 19/351, 23.

SIPERFAQA TOTALE NDERTESE = 152 M2 ND.

PRONARI DOGANA BERAT

Emer, Mbiemer, Firma

DOGANA BERAT

PLANIMETRIA E NDERTESES 1K PAS.NR.KAD.19/25

KATI I I-RE MAKAZINES SE MALLRAVE SEKUESTRO

SH 1:100 BERAT



Gjyzemin Kondaku
TOPOGRAFE
Nr Lic. T,Z, 0545

SIPERFAQA NDERTIMORE =152 M2 ND.


Plan Rilevimi
I PRONES
PERGATITI :
Emri: LUETA BANO
Licensa Nr:Tz 1070 Date 01.07.2013
Data e Pergatitjes:
IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale: 8501
Nr.i Pasurise:19/20,10,3,7,23,351,25,16 Vol.__ Fq.__
Indeksi i Hartes: BR:A-3,A-4
Shkalla: 1 : 500
Adresa e Pasurise: Rrethi BERAT
Q/F Berat LAGJA KOMBINATI TEKSTIL
P/G Sh K Ap TRUALL+ND.
DOGANA BERAT
Pronarifet
KUFIZIMET
V- BR;A-3, A- 4.
L- 19/45.
J. 19/41,46.
P. 1/290,1/87,1/291.
19/7
19/10
19/3
1/291
1/88



1- SIPERFAQA TOTALE TRUALL +ND. E PAS. ME NR.KAD.19/20 = 799M2 TRUALL i NGA KJO 137 M2 ND ZYRA +8M2 VENDROJE
2- SIPERFAQA TOTALE TRUALL E PAS. ME NR.KAD.19/10 = 4360 M2 TRUALL
3- SIPERFAQA TOTALE TRUALL+ ND. E PAS. ME NR.KAD.19/3 = 23 M2 TRUALL NGA KJO 23 M2 ND.
4- SIPERFAQA TOTALE ND. E PAS. ME NR.KAD.19/7 = 12M2 TRUALL NGA KJO 12M2 ND,
5- SIPERFAQA TOTALE ND. E PAS. ME NR.KAD.19/23 = 350 M2 TRUALL NGA KJO 350M2 ND
6- SIPERFAQA TOTALE ND. E PAS. ME NR.KAD.19/351 = 243M2 TRUALL NGA KJO 243M2 ND
7- SIPERFAQA TOTALE ND. E PAS. ME NR.KAD.19/25 = 352 M2 TRUALL NGA KJO 200M2 ND.
8- SIPERFAQA TOTALE TRUALL E PAS. ME NR.KAD.19/16 = 481M2 TRUALL
8- SIPERFAQA TOTALE TRUALL +ND E TE GJITHA PASURIVE = 6625 M2 TRUALL NGA KJO 973M2 ND.

(konform Vleh-se)


Plan Rilevimi
I PRONES
PERGATITI :
Emri: G.MYZEMINE KONDAKCIU
Licenca Nr.T 0545/1 Data 27/03/2018
Data e Perpunimit:
IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale: 8501
Nr.i Pasurise:19/20,10,3,7,23,351,25,16Vol._ Fq._
Indeksi i Hartes: BR:A-3,A-4
Shkalla: 1 : 500
Adresa e Pasurise: Rrethi BERAT
Q/F Berat LAGJA KOMBINATI TEKSTIL
P/G Sh K Ap TRUALL+ND.
DOGANA BERAT
Pronarilet
KUFIZIMET
V- BR;A-3, A- 4.
L- 19/45.
J. 19/41,46.
P. 1/290,1/67,1/291.
19/7
19/10
19/3
1/291
1/68



1- SIPERFAQA TOTALE TRUALL +ND. E PAS. ME NR.KAD.19/20 = 799M2 TRUALL NGA KJO 161 M2 ND, -4 m2 = 157

2- SIPERFAQA TOTALE TRUALL E PAS. ME NR.KAD.19/10 = 4360 M2 TRUALL

3- SIPERFAQA TOTALE TRUALL+ ND. E PAS. ME NR.KAD.19/3 = 28 M2 TRUALL NGA KJO 28M2 ND,

4- SIPERFAQA TOTALE ND. E PAS. ME NR.KAD.19/7 = 12M2 TRUALL NGA KJO 12M2 ND,

5- SIPERFAQA TOTALE ND. E PAS. ME NR.KAD.19/23 = 350 M2 TRUALL NGA KJO 350M2 ND

6- SIPERFAQA TOTALE ND. E PAS. ME NR.KAD.19/351 = 243M2 TRUALL NGA KJO 243M2 ND

7- SIPERFAQA TOTALE ND. E PAS. ME NR.KAD.19/25 = 352 M2 TRUALL NGA KJO 352M2 ND

8- SIPERFAQA TOTALE TRUALL E PAS. ME NR.KAD.19/16 = 481M2 TRUALL

8- SIPERFAQA TOTALE TRUALL +ND E TE GJITHA PASURIVE = 6625 M2 TRUALL NGA KJO 1146 M2 ND. -4 m2 = 1142 m2

VENDIM
Nr. 333, datë 22.5.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIM I SHESHIT TE LAGJJA 'LUGINA', BASHKIA SHIJAK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim i sheshit te lagjja 'Lugina', Bashkia Shijak".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Shijak.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall", me sipërfaqe 600 m^2, me vlerë të përgjithshme prej 1 828 200 (një milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 828 200 (një milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Shijak, planifikuar në buxhetin e saj me vendim të këshillit bashkiak.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë dhe të përfundojë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur pranë Bashkisë Shijak certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit, si dhe kartelën e pasurisë.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Shijak të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Shijak, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Shijak.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit: "Rikualifikim i sheshit tek lagjja Lugina" Bashkia Shijak

Tabela me numër pasurie 6/298

Nr.	Emër, Mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja truall/m²	Çmimi/ lekë/m²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Abdyl Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Hysni Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Nafie Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Servete Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Zenepe Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
	Totali					**914 100**	

Tabela me numër pasurie 6/299

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja truall/m²	Çmimi/ lekë/m²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Abdyl Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Hysni Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Nafie Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Servete Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Zenepe Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP
	Totali					**914 100**	

Vlera e përgjithshme e dy pasuritve: nr 6/298 dhe nr. 6/299 është:	**1 828 200 lekë**

VENDIM
Nr. 334, datë 22.5.2019

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Z. Harilla Dafa, prefekt i Qarkut të Beratit, lirohet nga kjo detyrë.
2. Znj. Valbona Zylyftari emërohet prefekt i Qarkut të Beratit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 335, datë 22.5.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 294, DATË 8.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për bashkëpunimin në mbështetje të klimës së investimeve dhe qeverisjes së mirë, nënshkruar më 24 shkurt 2014, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 294, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

"5. Këshilli i Investimeve kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga qeveria, sektori privat dhe partnerët për zhvillim, si më poshtë vijon:

a) anëtarë me status të përhershëm:

i. institucione shtetërore, 3 anëtarë:

- ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Banka e Shqipërisë;
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;

ii. partnerë zhvillimi, 3 anëtarë:

- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH);
- Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC)/Banka Botërore;
- Delegacioni i Bashkimit Evropian;

iii. Dhoma të Tregtisë dhe Industrisë, 2 anëtarë:

- Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

b) Anëtarë me status të përkohshëm me mandat 2-vjeçar:

i. Shoqata biznesi, 4 anëtarë.

c) anëtarë *ad-hoc*:

Shoqëri tregtare, 2 anëtarë.

Pjesëmarrja e anëtarëve me status të përkohshëm dhe *ad-hoc* caktohet nga sekretariati.

Përzgjedhja e shoqatave të biznesit bëhet duke pasur në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Numrin e anëtarëve, vitin e themelimit të shoqatave të biznesit dhe transparencën publike në qeverisjen e shoqatës;
- Përfaqësimin e investitorëve vendas e të huaj dhe sektorët që përfaqëson secila shoqatë biznesi;
- Materialet e publikuara, indekset e biznesit të përgatitura dhe analizat ligjore e ekonomike për çështje të klimës së biznesit;
- Angazhimin dhe kapacitetet për të përmbushur funksionet si anëtar në Këshillin e Investimeve.".

2. Pika 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

"16. Numri i mbledhjeve të rregullta të Këshillit të Investimeve të jetë, të paktën, 4 (katër) mbledhje në vit.".

3. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"18. Kostot e stafit, të mobilimit të zyrave e të komunikimit do të mbulohen nga BERZH-i dhe partnerët për zhvillim.".

4. Kudo në vendim:

a) Fjalët "ministrit për Zhvillimin Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" dhe "Ministria për Zhvillimin Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" zëvendësohen, përkatësisht, me "ministrit përgjegjës për ekonominë" dhe "ministria përgjegjëse për ekonominë";

b) Fjala "... donatorët ..." zëvendësohet me fjalët "... partnerët për zhvillim ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 336, datë 22.5.2019

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja "dh", 18, shkronja "e", dhe 32, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit për ndihmat shtetërore të vitit 2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RAPORTI VJETOR
PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2018

I. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor për ndihmat shtetërore është hartuar në zbatim të detyrimeve të sanksionuara në nenin 71, pika 5 të MSA-së dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbështetur në vendimet e Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Në mënyrën e paraqitjes dhe analizës së të dhënave në raport është ndjekur metodologjia e Komisionit Evropian.

Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga dhënësit dhe zbatuesit e skemave të ndihmës shtetërore: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Bashkia e Tiranës. Pavarësisht se ky raport është për vitin 2018, në të gjenden të dhëna për të gjithë periudhën 2015–2018, duke bërë një krahasim të ndihmës shtetërore, përgjatë këtyre viteve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në raport me ndihmën shtetërore, të dhënë në vendet e BE-së (kreu 3).

Raporti jep një përshkrim të objektivave kryesore që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumentet kryesore të përdorura në periudhën 2015–2018. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2015–2018 është vlerësuar në rreth 11,408.15 milionë lekë (85.76 milionë €), prej të cilave 3,697.28 milionë lekë (28.98 millionë €) që përfaqësojnë 0.22 % të PBB-së, janë dhënë në vitin 2018. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2018, vendin kryesor (rreth 60.3%) e zënë ndihmat horizontale, një strukturë e ngjashme me vendet e BE-së ku, mbi 94 % të ndihmës gjithsej është dhënë në kategoritë e ndihmave për realizimin e objektivave horizontalë ("ndihmë e mirë"). Megjithatë, pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin "*de minimis*" të Bashkimit Evropian dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2018 janë grantet dhe përjashtimi nga taksat, rimbursimi apo reduktimi i shkallës tatimore.

Në krahasim me vitin 2017, shkalla e ndihmës u rrit ndjeshëm për kulturën (+1.9 %) dhe ndihmën operacionale (+44.2 %).

Në vitin 2018 në Komisionin e Ndihmës Shtetërore u njoftuan 10 skema të ndihmës shtetërore. Buxheti mesatar vjetor i skemave të njoftuara ishte rreth 560.96 milionë lekë, një rritje prej rreth 1300 % krahasuar me vitin 2017.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, Raporti Vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2018 do t'i përcillet Komisionit Evropian.

II. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

- Baza ligjore

Në Shqipëri, ligji i ndihmës shtetërore përcakton rregullat e dhënies së ndihmës shtetërore duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, jep përkufizimin e ndihmës shtetërore, kushtet për miratimin e ndihmës shtetërore, kompetencat e strukturave përgjegjëse, procedurën e autorizimit, monitorimin dhe kthimin e ndihmës shtetërore si edhe detyrimin për hartimin e raportit vjetor për ndihmën shtetërore.

- Përkufizimi i ndihmës shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcaktohet se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore".

Gjithashtu neni 71 "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", i Marrëveshjes së

Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[1], përcakton se:

"*Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.*"

- Përfitues i ndihmës shtetërore

Përfitues i ndihmës shtetërore është çdo ndërmarrje ose individ që, nëpërmjet akteve dhe masave të ndërmarra nga shteti, siguron përfitime financiare. Në përcaktimin nëse një masë është ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar dhe të nenit 107(1) të TFEU-së, strukturat e ndihmës shtetërore vlerësojnë plotësimin e kritereve të mëposhtme:

- masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore,
- masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar, si edhe
- masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojnë në tregtinë midis Shteteve Anëtare.

Çfarë nuk përbën ndihmë shtetërore?

a) Ndihma për organet publike dhe njësive të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, të cilat kryejnë një aktivitet jo ekonomik;

b) Masa të përgjithshme të destinuara për të gjitha ndërmarrjet dhe të gjithë sektorët e ekonomisë në vend, të tilla si masat tatimore të përgjithshme etj.;

c) Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve me çmimin e tregut.

2.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale përfshin:

- ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion;
- ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- ndihmën për punësim;
- ndihmën për trajnim;
- ndihmën operacionale;
- ndihmën për sportin;
- ndihmën për kulturën.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- ndihmën për transportin publik;
- ndihmën për shërbimin publik;
- ndihmën për minierat;
- ndihmën për energjinë;
- ndihmën për turizmin.

Ndihma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente, si:

A1 - Subvencione dhe grante;

A2 - Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulje e shkallës së tatimit ose zbritje e kontributit në sigurimet shoqërore;

III. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2018

3.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2014–2018

A. Ndihma shtetërore krahasuar me treguesit kryesore socio-ekonomike

[1] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare".

Tabela nr. 1: Ndihma shtetërore krahasuar me disa me tregues socio-ekonomike 2014–2018

Treguesit	*Njësia e matjes*	*2014*	*Shkalla e ndihmës 2014*	*2015*	*Shkalla e ndihmës 2015*	*2016*	*Shkalla e ndihmës 2016*	*2017*	*Shkalla e ndihmës 2017*	*2018*	*Shkalla e ndihmës 2018*
PBB	*mld lekë*	1,394	0.23	1,435	0.26	1,530	0.11	1,555	0.14	1,648	0.22
Shpenzimet e buxhetit te shtetit	*mln lekë*	438,849	0.74	437,408	0.86	450,224	0.38	474,100	0.47	4,974,167	0.07
Të punësuar	*nr*	925,000	3,517	973,000	3,847	1,157,210	1,485	1,160,506	1,938	1,174,908	3,147
Popullsia	*nr*	2,885,792	1,127	2,875,592	1,302	2,876,591	597	2,878,977	781	2,873,744	1,287
Ndihma shtetërore	*mln lekë*	3,252.78		3,742.81		1,718.70		2,249.37		3,697.28	

Burimi: MFE dhe INSTAT

Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej në Shqipëri në periudhën 2014–2018, të krahasuara me disa tregues. Ndihma shtetërore gjithsej në vitin 2018 është dhënë në vlerën totale 3,697.28 milionë lekë (28.98 mln euro) e rritur me 64% e krahasuar me vitin 2017.

Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së u rrit nga 0.14 % në 2017, në 0.22 % në vitin 2018.

Grafiku nr. 1 paraqet shkallën e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së për periudhën 2014–2018.

Grafiku nr. 1: *Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB 2014–2018*



B. Shkalla e ndihmës shtetërore në Shqipëri dhe Bashkimin Evropian

Tabela nr. 2: Ndihma shtetërore 2016–2017

Shtetet	Shkalla nga PBB 2016	vlera gjithsej (mln euro)	Shkalla nga PBB 2017	vlera gjithsej (mln euro)
Shqiperia	**0.112**	**12.71**	**0.145**	**16.88**
European Union (28 countries)	0.679	101,298.5	0.722	110,685
Belgium	0.588	2,488.1	0.503	2,204.8
Bulgaria	1.014	488.2	1.314	662.9
Czech Republic	1.308	2,308.6	1.394	2,676.2
Denmark	0	4,460	0	4,396.8
Germany	0	40,363.9	0	42,313.2
Estonia	0.818	172.5	1.025	235.9
Ireland	0.148	406.9	0.178	528.3
Greece	0.356	619.3	0.24	427.3
Spain	0.203	2,272.8	0.26	3,023.4
France	0.67	14,924.8	0.735	16,824.6
Croatia	0.948	439.9	0.979	476.3
Italy	0.197	3,304	0.276	4,746.2
Cyprus	0.654	119.1	0.542	104.2
Latvia	2.377	592.4	1.625	436.3
Lithuania	0.836	323.2	1.054	441.4
Luxembourg	0.343	181.9	0.27	149.8
Hungary	2.007	2,282.7	2.533	3,127.5
Malta	0.537	54.8	0.797	88.6
Netherlands	0.275	1,931	0.268	1,962.3
Austria	0.516	1,821.5	0.47	1,736.6
Poland	1.06	4,513.4	1.519	7,070.7
Portugal	0.394	730.6	0.433	836.5
Romania	0.616	1,045	0.491	922.1
Slovenia	0.803	324.6	0.849	367.6
Slovakia	0.445	360.9	0.261	221.5
Finland	0.762	1,645.1	0.815	1,821.3
Sweden	5.617	3,659	6.655	4,335.3
United Kingdom	0.395	9,464.2	0.368	8,547.6

Burimi: *Komisioni Evropian, DG Competition*[2] *dhe MFE (%)*

Tabela nr. 2, paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për periudhën 2016–2017. Në tabelë janë përfshirë të dhënat e publikuara nga Komisioni Evropian deri në vitin 2017 për ndihmën shtetërore duke përjashtuar ndihmën që kanë dhënë shtetet anëtare për përballimin e krizës ekonomike dhe transportin.

Ndihma përfshin shpenzimet që ka kryer çdo shtet anëtare, e cila është orientuar për realizimin e objektivave horizontale me interes të përbashkët, ndihmën e dhënë për sektorët të ndryshëm të ekonomisë, si p.sh. transporti, si edhe ndihmën për arritjen e objektivave të veçantë, si p.sh. shpëtim dhe ristrukturim, ndihmën për mbylljen e ndërmarrjeve, duke përjashtuar ndihmën për sektorin e hekurudhave.

3.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

[2] http://ec.europa.eu/competition/state_aid/scoreboard/index_en.html

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:
- ndihmë shtetërore horizontale; dhe
- ndihmë shtetërore sektoriale;
- ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë;
- ndihma shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

Tabela nr. 3: Ndihma shtetërore gjithsej 2015–2018 ndarë sipas kategorive (në milionë lekë)

KATEGORIA	2015			2016			2017			2018		
	mln lekë	*mln euro*	*në %*	*mln lekë*	*mln euro*	*në %*	*mln lekë*	*mln euro*	*në %*	*mln lekë*	*mln euro*	*në %*
Ndihma Horizontale	**2,835.86**	**20.60**	**75.8%**	**827.00**	**6.11**	**48.1%**	**830.58**	**6.23**	**36.9%**	**2,228.48**	**17.47**	**60.3%**
Punësimi	285.34	2.07	7.6%	183.57	1.36	10.7%	196.79	1.48	8.7%	111.78	0.88	3.0%
Trajnim	136.69	0.99	3.7%	279.23	2.06	16.2%	276.98	2.08	12.3%	150.48	1.18	4.1%
Sport	2,058.00	14.95	55.0%	167.00	1.23	9.7%	218.80	1.64	9.7%	104.01	0.82	2.8%
Kultura	41.15	0.30	1.1%	111.27	0.82	6.5%	39.58	0.30	1.8%	134.00	1.05	3.6%
Ndihma operacionale	38.36	0.28	1.0%	-	-	0.0%	5.02	0.04	0.2%	1,642.90	12.88	44.4%
Kerkim, zhvillim dhe inovacion	247.27	1.80	6.6%	19.00	0.14	1.1%	46.08	0.35	2.0%	41.92	0.33	1.1%
SME	29.05	0.21	0.8%	66.93	0.49	3.9%	47.33	0.36	2.1%	43.39	0.34	1.2%
Ndihma Sektoriale	**906.95**	**6.59**	**24.2%**	**891.70**	**6.59**	**51.9%**	**1,418.79**	**10.65**	**63.1%**	**1,468.80**	**11.51**	**39.7%**
Transport publik (Hekurudha)	440.00	3.20	11.8%	390.00	2.88	22.7%	400.00	3.00	17.8%	400.00	3.14	10.8%
Shërbimi publik	430.00	3.12	11.5%	428.70	3.17	24.9%	974.90	7.32	43.3%	1,000.00	7.84	27.0%
Energjia	-	-	0.0%	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Minierat	36.95	0.27	1.0%	39.35	0.29	2.3%	35.00	0.26	1.6%	68.80	0.54	1.9%
Turizmi	-	-	0.0%	33.65	0.25	2.0%	8.89	0.07	0.4%	-	-	-
TOTALI	**3,742.81**	**27.19**	**100**	**1,718.70**	**12.71**	**100**	**2,249.37**	**16.88**	**100**	**3,697.28**	**28.98**	**100**

Burimi: *Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE*

Grafiku nr. 2: *Ndihma shtetërore sipas kategorive 2015–2018*



Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 2, tregojnë se në vitin 2018 ndihma shtetërore horizontale zë pjesën më të madhe të ndihmës shtetërore gjithsej me 60.3 %, ndërsa kategoria e ndihmave sektoriale përbën 39.7 %.

Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme të ndihmës shtetërore në vitin 2018 u rritën me rreth 64% krahasuar me shpenzimet e vitit 2017 (+1,447.91 milionë lekë). Ky ndryshim i përgjithshëm është si rezultat i faktorëve si: 1) ulje e ndihmës shtetërore për punësimin prej rreth 85.01 milionë lekësh; 2) ulje e ndihmës shtetërore për trajnimin prej 126.5 milionë lekësh; 3) ulje e ndihmës shtetërore për mbështetje e sportit prej 114.79 milionë lekësh; 4) rritje e ndihmës shtetërore për kulturën prej 94.42 milionë lekësh; 5) rritje e ndihmës operacionale prej 1,637.88 milionë lekësh; 6) ulje e ndihmës shtetërore për kërkimin dhe zhvillimin prej 4.16 milionë lekësh; 7) ulje e ndihmës shtetërore për SME-

të prej 3.94 milionë lekësh; 8) rritje e ndihmës shtetërore për shërbimin publik (ujësjellësit) prej 25.1 milionë lekësh; 10) rritje e ndihmës shtetërore për minierat prej 33.8 milionë lekësh.

Grafiku nr. 3, paraqet ndryshimin gjithsej të shpenzimeve të ndihmës shtetërore sipas objektivave ndërmjet 2017 dhe 2018 në Shqipëri (në milionë lekë)

Grafiku nr. 3 Ndryshimi i ndihmës mes vitit 2018–2017



Burimi: *MFE*

3.2.1 Ndihma Shtetërore Horizontale

Në vitin 2018 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 2,228.80 mln lekë (17.47 mln euro). Peshën kryesore për këtë kategori të ndihmës e ka ndihma operacionale me 74 %.

Tabela nr. 4: *Ndihma shtetërore horizontale 2014–2018*

Ndihma Horizontale	2014		2015		2016		2017		2018	
	mln LEK	*mln EUR*	*mln LEK*	*mln EUR*	*mln LEK*	*mln EUR*	*mln LEK*	*mln EUR*	*mln LEK*	*mln EUR*
Punësimi	150.08	1.07	285.34	2.07	183.57	1.36	196.79	1.48	112.10	0.88
Trajnim	109.84	0.78	136.69	0.99	279.23	2.06	276.98	2.08	150.48	1.18
Sport	644.00	4.60	2,058.00	14.95	167.00	1.23	218.80	1.64	104.01	0.82
Kultura	-	-	41.15	0.30	111.27	0.82	39.58	0.30	134.00	1.05
Ndihma operacionale	836.33	5.97	38.36	0.28	-	-	5.02	0.04	1,642.90	12.88
Kerkim, zhvillim dhe inovacion	359.82	2.57	247.27	1.80	19.00	0.14	46.08	0.35	41.92	0.33
SME	37.46	0.27	29.05	0.21	66.93	0.49	47.33	0.36	43.39	0.34
TOTALI	**2,137.53**	**15.26**	**2,835.86**	**20.60**	**826.99**	**6.11**	**830.58**	**6.23**	**2,228.80**	**17.47**

Burimi*: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE*

Grafiku nr. 4: *Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale 2015–2018*



Grafiku nr. 5: *Struktura e ndihmës shtetërore horizontale për vitin 2018*



Ndihma horizontale në vitin 2018 është në vlerën 2,228.80 milionë lekë. Në mënyrë më të detajuar të dhënat për ndihmën shtetërore jepen më poshtë:

Ndihma për punësim: Ndihma për punësim jepet nëpërmjet 7 skemave të ndihmës shtetërore. Skemat janë të miratuara me vendime të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, si më poshtë:

1. Vendimin e KNSH-së nr. 11 , datë 15.3.2007 "Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë"".

2. Vendimin e KNSH-së nr. 13, datë 15.3.2007 "Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional"".

3. Vendimin e KNSH-së nr. 38, datë 19.9.2011 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta"".

4. Vendimin e KNSH-së nr. 39, datë 19.9.2011 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë"".

5. Vendimin e KNSH-së nr. 40, datë 19.9.2011 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit për ofrimin e shërbimit të formimit profesional të punëkërkuesve të papunë nga persona juridikë/fizikë privatë dhe organizata jofitimprurëse"".

6. Vendimin e KNSH-së nr. 47, datë 28.3.2014 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar"".

7. Vendimin e KNSH-së nr. 62, datë 14.12.2015 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit"".

Nga skema e ndihmës shtetërore me qëllim nxitjen e punësimit kanë përfituar gjithsej 561 ndërmarrje, duke punësuar gjithsej 2,902 punëkërkues të papunë.

Ndihma për trajnim: Skema e ndihmës shtetërore e miratuar me vendimin e KNSH-së nr. 12, datë 15.3.2007 "Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë"", ka si qëllim trajnimin e punëkërkuesve të cilët më pas sigurojnë vendin e tyre të punës në ndërmarrje të cilat janë përfituese të ndihmës shtetërore. Në vitin 2018 kanë përfituar gjithsej 105 ndërmarrje duke u trajnuar 1,639 punëkërkues të papunë. Për këtë skemë të ndihmës shtetërore janë shpenzuar fonde nga buxheti i shtetit gjithsej në shumën 150.48 milionë lekë.

Ndihma për Sportin: Komisioni me vendimin nr. 54, datë 26.1.2015 "Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit". Për këtë skemë ndihme, objektivi kryesor i të cilës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, për vitin 2018 janë shpenzuar nga buxheti shtetit 104.01 milionë lekë.

Përfituesit e skemës janë federatat e ndryshme sportive që ofrojnë shërbime sportive për anëtarët e tyre, dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. Federatat shqiptare të sportit janë organizata jofitimprurëse, të cilat kanë për qëllim të zhvillojnë, promovojnë, kontrollojnë, dhe të rregullojnë aktivitetet sportive të shoqatave dhe klubeve, të cilat janë anëtarë të federatave të tyre, në përputhje me statutet e tyre.

Mbështetja me grante nga buxheti i shtetit jepet për:

- Federatat e ndryshme të sportit – financimin për mbulimin e kostove të personelit dhe investimeve.

- Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar – financimin për pjesën e kostos së mbuluar të personelit.

Ndihma për nxitjen e Kulturës: Në vitin 2018 ndihma shtetërore për nxitjen e kulturës është dhënë në vlerën 134 milionë lekë. Ndihma shtetërore është dhënë në formën e mbështetjes financiare me fonde publike për projektet me thirrje dhe në zbatim të prioriteteve institucionale në programin e fushës së Art-Kulturë. Objektivi i ndihmës është mbështetja e projekteve kulturore për individë dhe subjekte që në veprimtarinë e tyre kanë artin dhe kulturën në disiplina të ndryshme artistike si: teatër, muzikë, arte pamore, hulumtimin, ngritje infrastrukturore (rritje kapacitetesh).

Ndihma operacionale: Kjo kategori përfshin skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse të konsumuar në serat me ngrohje dhe industrinë. Për vitin 2018 raportohet se është dhënë ndihmë shtetërore në shumën 1,642.9 milionë lekë, nëpërmjet skemës së rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale.

Ndihma për kërkim dhe zhvillim: Sipas raportimit të Drejtorisë së përgjithshme të Tatimeve, ndihma shtetërore për kërkim dhe zhvillim është dhënë për ndërmarrjet që nënshkruajnë "marrëveshje hidrokarburesh" dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Në vitin 2018, është raportuar se kompanitë e huaja që kryejnë operacione hidrokarbure në Shqipëri kanë përfituar përjashtime në import (TVSH dhe përjashtime doganore), në shumën 41.92 milionë lekë (në vitin 2017 shuma e përjashtimeve ishte 46.08 milionë lekë).

Ndihma për SME: Në vitin 2018 nga skema e ndihmës shtetërore për SME-të kanë përfituar gjithsej 68 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, prej të cilave 48 ndërmarrje të mbështetura nga fondet e AIDA-s dhe 20 ndërmarrje nga skema e ndihmës shtetërore të dhënë nga Bashkia e Tiranës.

Vlera e ndihmës gjithsej për SME-të është 43.39 milionë lekë e ndarë në:

- Fondi i Ekonomisë kreative në vlerën 6 milionë lekë

-Fondi i Konkurrueshmërisë në vlerën 17,6 milionë lekë

- Fondi Start-up në vlerën 6,9 milionë lekë

- Fondi i Inovacionit në vlerën 2,8 milionë lekë

- Plani i ndihmës shtetërore për nxitjen e punësimit të krijimit të biznesit rinor në vlerën 10 milionë lekë në Bashkinë e Tiranës

3.2.2 Ndihma Shtetërore Sektoriale

Në vitin 2018 ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 1, 468.8 mln lekë (11.52 mln euro). Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2018 është 39.5 %.

Tabela nr. 5: *Ndihma shtetërore sektoriale 2014–2018*

Ndihma sektoriale	2014		2015		2016		2017		2018	
	mln LEK	*mln EUR*	*mln LEK*	*mln EUR*	*mln LEK*	*mln EUR*	*mln LEK*	*mln EUR*	*mln LEK*	*mln EUR*
Transporti publik	440.00	3.14	440.00	3.20	390.00	2.88	400.00	3.00	400.00	3.14
Shërbime publike	450.00	3.21	430.00	3.12	428.70	3.17	974.90	7.32	1,000.00	7.84
Energjia	195.25	1.39	-	-	-	-	-	-	-	-
Minierat	30.00	0.21	36.95	0.27	39.35	0.29	35.00	0.26	68.80	0.54
Turizmi	-	-	-	-	33.65	0.25	8.89	0.07	-	-
TOTALI	**1,115.25**	**7.96**	**906.95**	**6.59**	**891.70**	**6.59**	**1,418.79**	**10.65**	**1,468.80**	**11.52**

Burimi: *Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE*

Grafiku nr. 6: *Ecuria e ndihmës shtetërore sektoriale 2014–2018*



Grafiku nr. 7: *Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2018*



Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2018, peshën kryesore e zë ndihma për shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve), duke vijuar me ndihmën për transportin publik (hekurudha) dhe ndihmën për minierat (në mbyllje dhe konservim).

Ndihma për transportin publik e dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor është 400 milionë lekë edhe në vitin 2018.

Ndihma për shërbimet publike: Në vitin 2018 ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit të ndërmarrjeve të ujësjellës - kanalizime në shumën 1 miliard Lekë.

Ndihma për minierat: Ndihma për minierat nga buxheti i shtetit për vitin 2018 jepet për vazhdimin e mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe jo efektive, privatizimi i aseteve për të mundësuar monitorimin e fenomeneve të post shfrytëzimit në shumën 68.8 milionë lekë.

IV. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial

të pasurisë publike duke pasur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2018, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe incentivave fiskale. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen në:

A1 - Subvencione dhe grante;

A2- Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B - Pjesëmarrja në kapital;

C1 - Hua të buta;

C2 - Instrumente të tjera;

D – Garancitë.

Tabela nr. 6: *Ndihma shtetërore gjithsej sipas instrumenteve*

Kategoria e ndihmës	Subvencione dhe Grante (A1)	Përjashtim nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2)
Ndihma Horizontale		
Punësimi	111.78	
Trajnim	150.48	
Sport	104.01	
Kultura	134.00	
Ndihma operacionale		1,642.90
Kerkim, zhvillim dhe inovacion		41.92
SME	43.39	
Ndihma Sektoriale		
Transport publik (Hekurudha)	400.00	
Shërbimi publik	1,000.00	
Energjia	-	
Minierat	68.80	
Turizmi		
TOTALI	**2,012.46**	**1,684.82**

Burimi: *Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE*

Të dhënat në tabelën nr. 6 tregojnë se instrumenti i përdor më shumë është A1 - Subvencione dhe grante, sikurse paraqitet edhe në Grafikun nr. 8.

Grafiku nr.8: *Struktura e shpërndarjes të instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2018*



VENDIM
Nr. 337, datë 22.5.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3, DATË 9.1.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2019, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 3, datë 9.1.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2019, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 50 249 000 (pesëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e nëntë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

b) Pasqyra nr. 1 e vendimit zëvendësohet me pasqyrën nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Pasqyra nr. 1/1

PLANI I RISHIKUAR I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2019

Nr.	**Emërtimi i shpenzimeve**	**Viti 2019 (lekë)**
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	32,447,000
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4,840,000
3.	Shërbime e furniturë	11,882,000
4.	Investime	1,080,000
	TOTALI	**50,249,000**

VENDIM
Nr. 338, datë 22.5.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 787, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE EPRORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, 2 e 3, të nenit 39/2, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aneksi nr. 2, që i bashkëlidhet vendimit nr. 787, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI NR. 2
EMËRTESAT, KANDIDATURAT, FUNKSIONET DHE SPECIALITETET E KMCAP-ve EPRORE

Nr.	KMCAP	Kandidatura i/e propozuar	Kandidaturë alternative	Funksioni	Specialiteti
1	Sëmundje të brendshme (pneumoni /ftiziatri + patologji) (ISSH)	Edis Ibrahimi	Entela Dobi	anëtar	jurist
2	Kardiologji (ISSH)	Edvin Morava	Aljona Mansaku	anëtar	jurist
3	Neurologji (ISSH)	Soeda Doçaj	Erjona Xhuvani	anëtar	jurist
4	Kirurgji (ISSH)	Edlira Bako	Mirjon Brahimllari	anëtar	jurist
5	Ortopedi (ISSH)	Besmir Beja	Anairda Azizaj	anëtar	jurist
6	Psikiatri / okulistikë (ISSH)	Denisa Varfi	Najada Shundi	anëtar	jurist
7	Sëmundjet e shëndetit mendor (SHSSH)	Diana Stillo	Eljona Bylykbashi	anëtar	jurist
8	Sëmundjet e përgjithshme (SHSSH)	Odeta Fëngjilli	Elda Zenelaj	anëtar	jurist
9	Verbëri (SHSSH)	Avjerina Bazaj	Artan Syziu	anëtar	jurist
10	Paratetraplegji (SHSSH)	Esmeralda Velaj	Dejvi Çelçima	anëtar	jurist

VENDIM
Nr. 343, datë 2.5.2019

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE BUXHETORE PËR INSTITUCIONET E SISTEMIT TË DREJTËSISË, PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 11, 13 dhe 18, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numrat për 50 dhe 1 389 punonjës, miratuar në buxhetin e vitit 2019, përkatësisht, për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, rialokohen për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Numri rezervë për punonjës, miratuar në buxhetin e vitit 2019, për institucionet e sistemit të drejtësisë, pakësohet me 119 punonjës, duke e çuar numrin rezervë në 131 punonjës. Numri i përdorur nga rezerva alokohet përkatësisht, për:

a) 54 punonjës për Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke e çuar numrin e përgjithshëm të institucionit në 1 493 punonjës;

b) 65 punonjës për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

3. Fondet e grupit buxhetor "Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor", miratuar në buxhetin e vitit 2019, në grupin buxhetor nr.29, rialokohen në të njëjtat programe, llogari ekonomike buxhetore dhe në të njëjtat vlera, në grupin buxhetor "Këshilli i Lartë Gjyqësor".

4. Fondet e programit "Veprimtaria mbikëqyrëse e KLD", miratuar në buxhetin e vitit 2019, në grupin buxhetor nr. 63, "Institucione të sistemit të drejtësisë", rialokohen në të njëjtat llogari ekonomike buxhetore dhe në të njëjtat vlera, në programin "Planifikim, menaxhim dhe administrim" në grupin buxhetor "Këshilli i Lartë Gjyqësor".

5. Në grupin buxhetor "Këshilli i Lartë Gjyqësor", në programin "Planifikim, menaxhim dhe administrim" shtohet fondi prej 82 000 000 (tetëdhjetë e dy milionë) lekësh, përkatësisht, për shpenzime personeli në masën 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekë, për shpenzime operative në masën 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekë dhe për shpenzime kapitale në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

6. Në grupin buxhetor, të riaktivizuar, nr. 35, "Këshilli i Lartë i Prokurorisë", në programin "Planifikim, menaxhim dhe administrim" shtohet fondi prej 108 000 000 (njëqind e tetë milionë) lekësh, përkatësisht, për shpenzime personeli në masën 68 000 000 (gjashtëdhjetë e tetë milionë) lekë, për shpenzime operative në masën 20 000 000

(njëzet milionë) lekë dhe për shpenzime kapitale në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

7. Fondet financiare, të parashikuara në pikat 5 e 6, të këtij vendimi, në masën 190 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë milionë) lekë, përballohen nga fondi rezervë, miratuar në buxhetin e vitit 2019, për institucionet e reja të sistemit të drejtësisë, duke e çuar këtë fond në masën 210 000 000 (dyqind e dhjetë milionë) lekë.

8. Të drejtat, detyrimet si dhe dokumentacioni administrativ dhe financiar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, i kalojnë dhe administrohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

9. Ngarkohen Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 344, datë 22.5.2019

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 744, DATË 5.11.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, TË OBJEKTIT 'FAKULTETI I GJEOLOGJISË DHE MINIERAVE', TIRANË, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT/UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS, TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR GJYKATËN E LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 744, datë 5.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin, në përgjegjësi administrimi, të objektit "Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave", Tiranë, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit/Universiteti Politeknik i Tiranës, te Ministria e Drejtësisë, për Gjykatën e Lartë", të ndryshuar me vendimin nr. 732, datë 8.12.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 744, datë 5.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin, në përgjegjësi administrimi, të objektit 'Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave', Tiranë, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit/Universiteti Politeknik i Tiranës, te Ministria e Drejtësisë, për Gjykatën e Lartë".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Lartë, Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave dhe drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 346, datë 22.5.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 337, DATË 22.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KRYERJES SË PROCESIT TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në shkronjën "c", të pikës 2, fjalët "... të cilët nuk kanë ndryshuar vendbanimin që prej kësaj datë ..." hiqen.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje:

"3/1. Familjet bujqësore ose individët, përdorues faktikë të tokës për veprimtari bujqësore, që kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore më 1.8.1991, gjendja civile e të cilëve u është transferuar në fshatin ku gjendet toka, objekt i kalimit në pronësi, pas datës 1.8.1991, të cilët nuk kanë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo pronësi në fshatin ku kanë pasur gjendjen civile më 1.8.1991 paraqesin në bashki:

a) kërkesën për pajisjen me AMTP për tokën që e kanë në përdorim faktik për veprimtari bujqësore;

b) planvendosjen e secilës ngastër që kanë në përdorim faktik, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët. Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive nëpërmjet topografëve të vet;

c) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile e bashkisë, në datën e transferimit të gjendjes civile në fshatin ku gjendet toka, objekt i kalimit në pronësi;

ç) dokumentacionin që vërteton se janë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore më 1.8.1991;

d) vërtetimet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, DAMT-ja dhe bashkia, ku kërkuesi ka pasur regjistrimin e gjendjes civile në datën 1.8.1991, se nuk është trajtuar me tokë në pronësi apo përdorim.

3/2. Familjet bujqësore ose individët, përdorues faktikë të tokës për veprimtari bujqësore, që nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore, por kanë qenë banorë të fshatit ku gjendet toka, objekt i kalimit në pronësi, sipas regjistrit të gjendjes civile më 1.8.1991, por të mos kenë përfituar më parë tokë bujqësore në përdorim apo pronësi, paraqesin, në bashki:

a) kërkesën për pajisjen me AMTP për tokën që e kanë në përdorim faktik për veprimtari bujqësore;

b) planvendosjen e secilës ngastër që kanë në përdorim, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët. Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive nëpërmjet topografëve të vet;

c) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile e njësisë së qeverisjes vendore, sipas gjendjes më 1 gusht 1991, me ndryshimet deri më 1 tetor 1992, në fshatin ku gjendet toka, objekt i kalimit në pronësi;

ç) vërtetimet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe DAMT-ja, në juridiksionin e të cilave gjendet toka bujqësore, se nuk është trajtuar me tokë në pronësi apo përdorim.".

3. Në shkronjën "dh", të pikës 11, fjalët "… vendimit nr.45, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore, të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave …"" zëvendësohen me "… legjislacionit në fuqi …".

4. Pas shkronjës "dh", të pikës 11, shtohen shkronjat "e", "f" dhe "g", me këtë përmbajtje:

"e) Ministrisë përgjegjëse për ekonominë, të përcaktojë, për të gjitha ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në materialin hartografik, nëse janë objekt i investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë.

f) Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, DAMT-së dhe bashkisë, ku përdoruesi sipas pikës 3/1, të këtij vendimi, ka pasur regjistrimin e gjendjes civile më 1.8.1991, informacionin, nëse ky përdorues është trajtuar me tokë bujqësore në pronësi apo përdorim dhe në se kjo tokë është e regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme.

g) Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe DAMT-së, në juridiksionin e të cilave gjendet toka bujqësore, ku përdoruesi sipas pikës 3/2, të këtij vendimi, ka pasur regjistrimin e gjendjes civile më 1.8.1991, informacionin nëse ky përdorues është trajtuar me tokë bujqësore, në pronësi apo përdorim, si dhe nëse kjo tokë është e regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme.".

5. Kudo në tekstin e vendimit bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) termi "komunë" hiqet;

b) emërtimi "Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" zëvendësohet me "Agjencia Shtetërore e Kadastrës";

c) emërtimi "drejtoritë rajonale të bujqësisë" zëvendësohet me "agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor";

ç) emërtimi "Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave" zëvendësohet me "Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural".

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës dhe agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 347, datë 22.5.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT TEK ORGANIZATAT E PESHKIMIT, NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE DHE SUBJEKTET PRIVATE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe të infrastrukturës së lidhur me peshkimin.

2. Fitimi i së drejtës së menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin realizohet nëpërmjet procedurës së konkurrimit, zhvilluar nga ministria përgjegjëse për peshkimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

3. Me qëllim transferimin e infrastrukturës së peshkimit, ministria përgjegjëse për peshkimin duhet të ketë parasysh që procesi i transferimit të garantojë plotësimin e kushteve, si më poshtë vijon:

a) mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit;

b) ruajtjen dhe garantimin e interesit publik;

c) përdorimin dhe/ose përmirësimin e infrastrukturës;

ç) vendosjen e infrastrukturës në shërbim të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e peshkimit;

d) ofrimin e shërbimit me cilësi të lartë.

4. Procedurat e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe të infrastrukturës së lidhur me peshkimin zhvillohen nga ministria përgjegjëse për peshkimin, me kërkesë apo nismë të organizatave të peshkimit, njësive të vetëqeverisjes vendore apo subjekteve private.

5. Transferim, në kuptim të këtij vendimi, konsiderohet transferimi i së drejtës së menaxhimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

6. Infrastruktura e lidhur me peshkimin, që u transferohet në menaxhim subjekteve private, përbëhet nga shkallët e riparimit të anijeve të peshkimit ose sipërfaqe për ndërtimin e tyre, si dhe nga depozitat e karburantit, të cilat ndihmojnë për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit.

7. Depozitat e karburantit u transferohen në menaxhim subjekteve private, të cilat plotësojnë kushtet e pikës 2, të nenit 20, të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për akcizat"", të ndryshuar.

8. Shkallët e riparimit të anijeve të peshkimit, të klasifikuara si veprimtari për konstruksion, shërbim mirëmbajtjeje të mjeteve lundruese të peshkimit, u transferohen subjekteve private nëpërmjet procedurës së konkurrimit publik, zhvilluar sipas përcaktimeve të kreut II, të këtij vendimi.

9. Kriteret e konkurrimit për infrastrukturën e lidhur me peshkimin, sipas pikës 8, të kreut I, të këtij vendimi, që u transferohen subjekteve private, nëpërmjet kontratës së qirasë/enfiteozës, janë, si më poshtë vijon:

a) niveli i investimit;

b) niveli i punësimit;

c) oferta e detyrimit mujor të qirasë.

10. Të drejtën e lidhjes së kontratës së enfiteozës për pasuritë shtetërore, me afat deri në

20 (njëzet) vjet, e ka ministria përgjegjëse për peshkimin.

11. Afati i lidhjes së kontratës së qirasë është deri në 20 (njëzet) vjet.

12. Për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, vlera dysheme e detyrimit mujor përcaktohet si shumë e vlerës së qirasë mujore për pasurinë që jepet me qira ose enfiteozë, të llogaritura, si më poshtë vijon:

a) qiraja e infrastrukturës së lidhur me peshkimin, që do të jetë objekt i kontratës së qirasë/enfiteozës, është 100 (njëqind) lekë/m^2 në muaj;

b) në rast se do të jepen me qira depozitat e karburantit, vlera e qirasë mujore është 400 (katërqind) lekë/m^3 në muaj.

13. Subjekteve qiramarrëse/enfiteozëmarrëse, në asnjë rast, nuk u lind e drejta e privatizimit të objektit të kontratës.

14. Kriteret dhe procedura e transferimit të pjesës tjetër të infrastrukturës së lidhur me peshkimin do të rregullohen në krerët III e V, të këtij vendimi.

II. PROCEDURAT E DHËNIES ME QIRA OSE ENFITEOZË TË SHKALLËVE TË RIPARIMIT TË ANIJEVE TE SUBJEKTET PRIVATE

1. Ministria përgjegjëse për peshkimin, në cilësinë e administruesit të pasurisë, që do të jepet me qira ose enfiteozë, për të gjitha rastet, përgatit dokumentacionin dhe të dhënat, si më poshtë vijon:

a) certifikatën e pronësisë së bashku me hartën treguese të regjistrimit;

b) propozimin për dhënien me qira ose enfiteozë të objektit, të sipërfaqes, e cila përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri dhe afatin e dhënies me qira;

c) genplanin e objektit, të sipërfaqes, në 5 (pesë) kopje origjinale, të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe të konfirmuar nga drejtuesi i institucionit shtetëror, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, ku të jenë përcaktuar qartë sipërfaqja totale e pasurisë dhe sipërfaqja e pasurisë që do të jepet me qira/enfiteozë;

ç) tarifën dysheme të detyrimit mujor për sipërfaqet, sipas përcaktimeve në këtë vendim dhe duke pasur parasysh edhe gjendjen fizike të objektit;

d) në rastet e propozimit për dhënien me enfiteozë të objektit, përveç sa më sipër, duhet të specifikohet edhe vlera kontabël e pasurisë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës.

2. Në urdhrin e ministrit, për dhënien me qira ose enfiteozë, me konkurrim, të pasurisë shtetërore, përcaktohen:

a) të dhënat për pasurinë shtetërore që jepet me qira apo enfiteozë: emërtimi, sipërfaqja, zona kadastrale, qëllimi i përdorimit, vlera dysheme e detyrimit mujor të llogaritur sipas tarifave të këtij vendimi dhe afati;

b) veprimtaria që mund të ushtrohet në objekt;

c) pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, sipas pikës 8, të kreut I, të këtij vendimi;

ç) vendi, data dhe ora, ku paraqiten dokumentet;

d) përbërja e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, minimalisht me tre veta, një kryetar dhe dy anëtarë;

dh) dokumentacioni që paraqitet nga konkurrentët për konkurrim.

3. Njoftimi për publikim për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore shpallet 1 (një) herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në njoftim përcaktohen të dhënat për objektin, kategorizimin e veprimtarisë që do të ushtrohet në objekt, afati i dhënies me qira ose enfiteozë, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacioni që do të paraqesin konkurrentët, si dhe vendi, data e ora e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

4. Dokumentacioni për marrjen me qira, që paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit dhe përmban:

a) kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit;

b) planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni, si më poshtë vijon:

i. identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;

ii. përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;

iii. analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;

iv. niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.

Nëse kërkesa e subjektit është për një afat kohor mbi 5 (pesë) vjet, plani i biznesit të jetë i përshkruar hollësisht me të dhënat për 5 (pesë) vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër.

c) deklaratat në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:

i. deklaratë për të dhënat e NIPT-it/NUIS-it të subjektit kërkues;

ii. deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;

iii. deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore lidhur me aktivitetin;

iv. deklaratë lidhur me burimin e të ardhurave të nevojshme për kryerjen e investimit;

v. deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore; në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;

vi. deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e shkualifikon subjektin konkurrues.

5. Dokumentacioni për marrjen me enfiteozë, që paraqesin konkurrentët, të cilët duhet të jenë shoqëri tregtare, i dorëzohet komisionit dhe përmban:

a) kërkesën e subjektit për marrje me enfiteozë të pasurisë shtetërore, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit kryesorë financiarë të parashikuar sipas planit të biznesit;

b) CV-në e subjektit, ku të tregohet përvoja në fushën e aktivitetit ekonomik që do të ushtrohet në pasurinë që jepet me enfiteozë, të shoqëruar me dokumentacion vërtetues;

c) planbiznesin e hollësishëm për përmirësimin e pronës;

ç) përshkrimin e projektideve të investimit, të dhëna për nivelin e investimeve të parashikuara në pasuri të paluajtshme dhe në objektin në tërësi, shoqëruar me projekte, skica dhe dokumentacion tjetër paraprak, si dhe burimin e financimit të projektit;

d) deklaratat, në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:

i. deklaratë për të dhënat e NIPT-it/NUIS-it të subjektit kërkues;

ii. deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore;

iii. deklaratë për administratorin dhe për subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore lidhur me aktivitetin;

iv. deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore; në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;

v. deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e shkualifikon subjektin konkurrues.

6. Komisioni i dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore kryen këto detyra:

a) merr në dorëzim zarfet e mbyllura të konkurrentëve pjesëmarrës dhe i hap në prani të tyre, i lexon dhe u bën të njohur të dhënat kryesore të dokumenteve dhe të treguesve konkurrues, për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti nuk kualifikohet në prani të tij;

b) harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruan pjesëmarrësit, konkurrentët e shkualifikuar dhe arsyen, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre;

c) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura, verifikon dokumentacionin e paraqitur nëpërmjet platformës elektronike *e-Albania* ose, nëpërmjet komunikimit e ndërveprimit ndërinstitucional, sipas përcaktimit në urdhrin e ministrit, dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimi, sipas përcaktimit në urdhrin e ministrit. Subjektit që paraqet vlerën më të lartë të propozuar i jepen pikët maksimale të çdo elementi konkurrimi, ndërsa subjekteve të tjera u llogariten pikët në përpjesëtim të drejtë me vlerën më të lartë të propozuar. Në përfundim, konkurruesit renditen në bazë të shumës së pikëve të përfituara;

ç) në rastet e pamundësisë teknike të funksionimit të platformës elektronike *e-Albania* për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit, komisioni do të marrë në shqyrtim dokumentet e paraqitura me shkrim, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf, nga ofertuesit. Në rast të pamundësisë për shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit në njërën prej formave të përcaktuara më sipër, komisioni do të vijojë me shtyrjen e arsyetuar të afatit jo më shumë se 5 (pesë) ditë;

d) në rast se rezultojnë të dhëna të ndryshme nga të dhënat e dokumentacionit të paraqitur në formën e vetëdeklarimit në konkurrim, automatikisht subjekti shkualifikohet, ndërsa procedurat vazhdojnë me subjektin e klasifikuar në vendin e dytë. Metodologjia e vlerësimit të kritereve të konkurrimit parashikohet në udhëzimin që do të dalë në zbatim të këtij vendimi;

dh) paraqet, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën "c", të kësaj pike, te ministri, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, informacion për zhvillimin e konkurrimit, së bashku me procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit dhe listën e konkurruesve të renditur sipas pikëve të fituara.

7. Ministri vendos për subjektin fitues në konkurrim. Kur në konkurrim marrin pjesë më shumë se një konkurrues, njoftimi për shpalljen e fituesit vendoset në këndin e njoftimeve të institucionit përkatës.

8. Subjektet konkurruese, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te ministri, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, i kthen përgjigje me shkrim ankuesit.

9. Pas përfundimit të procedurave të lartpërmendura, fillojnë procedurat për hartimin dhe lidhjen e kontratës së qirasë ose të enfiteozës.

10. Kontratat e qirasë/enfiteozës, të lidhura nga ministria përgjegjëse për peshkimin, do t'i përmbahen formatit "tip", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Kur subjekti fitues tërhiqet, procedurat e lidhjes së kontratës vazhdojnë me subjektin e klasifikuar në vend të dytë.

12. Para nënshkrimit të kontratës së qirasë ose të enfiteozës, qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e tre muajve të pagesës së qirasë ose të enfiteozës. Garancia ngurtësohet deri në fund të kontratës dhe i kthehet qiramarrësit ose enfiteozëmarrësit me përfundimin e kontratës. Kthimi i garancisë së kontratës realizohet pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet e marrëveshjes kontraktore. Në rast se kontrata zgjidhet nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi, për shkaqe, për të cilat qiradhënësi ose enfiteozëdhënësi nuk mund të mbajë përgjegjësi, garancia mbahet si penalitet.

13. Brenda 1 (një) muaji nga nënshkrimi i kontratës, enfiteozëmarrësi aplikon pranë institucioneve shtetërore për t'u pajisur me lejet përkatëse të ushtrimit të veprimtarisë (leje mjedisore, leje /autorizim për përdorim burimi ujor, leje ndërtimi). Në rast se enfiteozëmarrësi / qiramarrësi nuk pajiset me lejet si më sipër, kontrata pushon automatikisht së vepruari, pa mbajtur garancinë e kontratës së qirasë/enfiteozës.

III. KONTRATA ME TARIFË SIMBOLIKE 1 (NJË) EURO

1. Infrastruktura e lidhur me peshkimin (shkallët e riparimit), në portet e peshkimit, për veprimtari për konstruksion, shërbim mirëmbajtjeje të mjeteve detare lundruese, u jepet subjekteve private edhe me kontrata qiraje/enfiteozë, me tarifë 1 (një) euro/kontrata, me vendim, rast pas rasti, të Këshillit të Ministrave.

2. Afati i lidhjes së kontratës me tarifë simbolike 1 (një) euro/kontrata është 20 (njëzet) vjet.

3. Ministria përgjegjëse për peshkimin i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e lidhjes së kontratës së qirasë/enfiteozës jo me çmimin fitues, por me çmimin 1 (një) euro / kontrata kur, pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, rezulton fitues një subjekt, i cili propozon që në pasurinë shtetërore do të kryejë një investim mbi 100 000 000 (njëqind milionë) lekë. Propozimi shoqërohet me projektkontratën e negociuar ndërmjet palëve.

4. Palët, me marrëveshje, përcaktojnë në kontratë që investimi në infrastrukturë kalon në pronësi të qiradhënësit/enfiteozëdhënësit, në përfundim të afatit të kontratës së qirasë / enfiteozës.

5. Para nënshkrimit të kontratës së qirasë/enfiteozës me tarifë 1 (një) euro/kontrata, qiramarrësi/ enfiteozëmarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës në masën 2 (dy) për qind të vlerës së investimit të marrë përsipër në konkurrim. Garancia kthehet pas përfundimit të investimit.

6. Kontrata e qirasë/enfiteozës me tarifë 1 (një) euro/kontrata do t'i përmbahet formatit "tip", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Në kontratën me tarifë 1 (një) euro/kontrata vendosen sanksione për rastet kur qiramarrësi / enfiteozëmarrësi nuk realizon kushtet e saj. Bazuar në parashikimet e kontratës, për mosrealizimin e vlerës së investimit të parashikuar në kontratë, subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrësi penalizohet me 10 (dhjetë) për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Ky sanksion do të vendoset pas dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të certifikuara nga eksperti kontabël i miratuar.

8. Nëse investimi nuk realizohet pas 6 (gjashtë) muajsh, sipas afateve të përcaktuara në planbiznes, në rastin e kontratave të qirasë dhe në rastin e kontratave të enfiteozës, kontrata zgjidhet në mënyrë të njëanshme, duke mbajtur garancinë e kontratës së qirasë/enfiteozës. Zgjidhja e kontratës bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Brenda 1 (një) muaji nga nënshkrimi i kontratës, enfiteozëmarrësi aplikon pranë institucioneve shtetërore për t'u pajisur me lejet përkatëse të ushtrimit të veprimtarisë (leje mjedisore, leje/autorizim për përdorim burimi ujor, leje ndërtimi). Fillimi i afatit të kontratës dhe detyrimet kontraktore sipas pikës 8, të kreut III, të këtij vendimi, lindin në momentin e marrjes së lejeve përkatëse. Në rast se enfiteozëmarrësi/qiramarrësi nuk pajiset me lejet si më sipër, bëhet zgjidhja e kontratës me vendim të Këshillit të Ministrave pa mbajtur garancinë e kontratës së qirasë/enfiteozës.

IV. TRANSFERIMI I MENAXHIMIT TË TREGUT TË SHITJES ME SHUMICË TE NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

1. Tregu i shitjes me shumicë menaxhohet nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës. Një treg i shitjes me shumicë mund t'u transferohet në menaxhim njësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Procedurat e transferimit të menaxhimit të një tregu të shitjes me shumicë kryhen nga ministri përgjegjës për peshkimin, me kërkesë të njësive të vetëqeverisjes vendore.

3. Të ardhurat e menaxhimit duhet të mbulojnë vetëm shpenzimet e nevojshme për funksionimin e tregut, shërbimet relative, amortizimin dhe përmirësimin e strukturave.

4. Menaxhuesi i tregut të shitjes me shumicë merr përsipër përballimin e kostove të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së tregut të shitjes me shumicë, përfshirë edhe taksat e aplikueshme nga legjislacioni në fuqi dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e tij, ku përfshihen mirëmbajtja e ndërtesave të administratës dhe të reparteve ndihmëse, mirëmbajtja e mjediseve higjieno-sanitare, shërbimet e mbledhjes së mbeturinave të lëngëta dhe të ngurta, mirëmbajtja e infrastrukturës për furnizim me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, si dhe pagesat kundrejt enteve shtetërore përkatëse.

5. Transferimi i menaxhimit të një tregu të shitjes me shumicë te njësitë e vetëqeverisjes vendore kryhet mbi bazën e kërkesës së njësisë së vetëqeverisjes vendore të shoqëruar nga plani i menaxhimit të tregut të shitjes me shumicë.

6. Plani i menaxhimit duhet të përcaktojë qëllimin, objektivat e vendosura, rezultatet e pritshme dhe burimet e nevojshme njerëzore, financiare, arritjen e objektivave, ndjekjen e ecurisë së punës gjatë fazave të ndryshme të saj, parashikimin e investimeve, organizimin së bashku me ndarjen e detyrave.

7. Pranë drejtorisë përgjegjëse për peshkimin në ministri ngrihet një komision me urdhër ministri, i cili, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës, shqyrton propozimin dhe dokumentacionin shoqërues të dorëzuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe, nëse e gjen në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të këtij vendimi, i përcjell dokumentacionin, për mendim, Komisionit Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën (në vijim "KKQPA"), i cili vepron sipas parashikimeve të nenit 21, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

8. Pas dhënies së mendimit nga KKQPA-ja, komisioni propozon transferimin e menaxhimit të tregut të shitjes me shumicë. Ministri miraton urdhrin për miratimin e transferimit të menaxhimit të tregut të shitjes me shumicë te njësia e vetëqeverisjes vendore dhe ngarkon komisionin që të negociojë marrëveshjen e transferimit të menaxhimit, sipas formatit "tip" të marrëveshjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Marrëveshja për transferimin e menaxhimit të tregut të shitjes me shumicë te njësia e vetëqeverisjes vendore lidhet për një afat deri në 20 (njëzet) vjet.

10. Njësia e vetëqeverisjes vendore me transferimin e tregut të shitjes me shumicë garanton mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit, ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të tregut të shitjes me shumicë që i është dhënë në përdorim.

11. Njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për shfrytëzimin racional të tregut të shitjes me shumicë, në mënyrë që të sigurojë mbështetjen e zhvillimit normal të veprimtarisë së peshkimit dhe tregtimit të produkteve peshkore.

V. TRANSFERIMI I MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT TEK ORGANIZATAT E PESHKIMIT

1. Transferimi i menaxhimit të infrastrukturës së porteve të peshkimit dhe/ose tregut të shitjes me shumicë i bëhet organizatës së peshkimit mbi bazën e kërkesës zyrtare të kësaj të fundit.

2. Kërkesa e organizatës së peshkimit për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së portit të peshkimit dhe/ose tregut të shitjes me shumicë paraqitet në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila duhet të jetë e shoqëruar me vendimin e regjistrimit, aktin e themelimit, statutin, vendimin e organeve vendimmarrëse të organizatës së peshkimit për këtë qëllim, sipas statutit të saj, planin e menaxhimit të miratuar nga organet drejtuese të organizatës së peshkimit.

3. Plani i menaxhimit duhet të përcaktojë qëllimin, objektivat e vendosura, rezultatet e pritshme dhe burimet e nevojshme njerëzore, financiare, arritjen e objektivave, ndjekjen e ecurisë së punës gjatë fazave të ndryshme të saj, parashikimin e investimeve, organizimin së bashku me ndarjen e detyrave.

4. Pranë drejtorisë përgjegjëse për peshkimin, në ministri ngrihet një komision me urdhër ministri, i cili, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës, shqyrton propozimin dhe dokumentacionin shoqërues të dorëzuar nga Organizata e Peshkimit dhe, nëse e gjen në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të këtij vendimi, i përcjell dokumentacionin për mendim KKQPA-së, i cili vepron sipas parashikimeve të nenit 21, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

5. Pas dhënies së mendimit nga KKQPA-ja, komisioni propozon transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së portit të peshkimit. Ministri miraton urdhrin për miratimin e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së portit të peshkimit organizatës së peshkimit dhe ngarkon komisionin që të negociojë marrëveshjen e transferimit të menaxhimit, sipas formatit "tip" të marrëveshjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shtojcën 3, dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Marrëveshja për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin tek organizata e peshkimit, lidhet për një afat deri në 20 (njëzet) vjet.

7. Organizata e Peshkimit, me transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së portit të peshkimit, zbaton kushtet e vendosura nga neni 64, i ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, duke garantuar mosndryshimin e destinacionit dhe të qëllimit, përdorimin e infrastrukturës së peshkimit nga ana e shtetit në rastet e masave të jashtëzakonshme, ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të strukturave portuale të peshkimit, që i janë dhënë në përdorim.

8. Organizata e Peshkimit është përgjegjëse për shfrytëzimin racional të portit, në mënyrë që të sigurojë mbështetjen e zhvillimit normal të veprimtarisë së peshkimit dhe tregtimit të produkteve peshkore.

9. Organizata e Peshkimit merr përsipër përballimin e kostove të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së portit/tregut të shitjes me shumicë, përfshirë edhe taksat e aplikueshme nga legjislacioni në fuqi dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e portit të peshkimit/tregut të shitjes me shumicë, ku përfshihen mirëmbajtja e ndërtesave të administratës dhe të reparteve ndihmëse, grumbullimi i mbetjeve të ngurta apo të lëngëta, të gjeneruara në territorin e portit, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, mirëmbajtja e infrastrukturës për furnizim me energji elektrike, karburante dhe ujë të pijshëm, si dhe pagesat kundrejt enteve shtetërore përkatëse, mirëmbajtja e mjediseve higjieno-sanitare të portit, mirëmbajtja e kalatave, bankinave notuese, kalunave etj.

10. Organizata e Peshkimit duhet të përdorë në mënyrë të drejtë e të barabartë për të gjithë anëtarët e saj portin e peshkimit, në mënyrë që të nxisë e të mbrojë interesat e përdoruesve.

11. Organizata e Peshkimit duhet të administrojë portin e peshkimit/tregun e shitjes me shumicë në mënyrë racionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, për të nxitur mbrojtjen e

mjedisit e të atij detar dhe një zhvillim të qëndrueshëm.

12. Organizata e Peshkimit duhet të krijojë të gjitha kushtet për inspektimin nga ana e organeve shtetërore, të ngarkuara nga ligji, të portit dhe të strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit që ajo administron.

13. Marrëdhëniet e organizatës së peshkimit me organet shtetërore rregullohen sipas parashikimeve të nenit 64, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi.

14. Organizata e Peshkimit është përgjegjëse për sigurinë dhe sigurimin në territorin e portit të peshkimit që ka në menaxhim.

15. Organizata e Peshkimit programon dhe merr masa për vendosjen e sigurt të anijeve të peshkimit në kalatë apo bankina notuese, duke respektuar rregullat dhe rregulloret e hartuara për këtë qëllim.

16. Organizata e Peshkimit krijon kushte për përpunimin e anijeve të peshkimit në port (shkarkimin e peshkut të zënë, furnizimin me karburant, me ujë të pijshëm dhe bazë materiale e teknike të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit).

17. Organizata e Peshkimit u jep me qira anëtarëve të saj dhomat frigoriferike dhe ambientet e tjera në shërbim të aktivitetit të peshkimit. Tarifat e qirasë dhe të shërbimeve përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për peshkimin dhe të ministrit përgjegjës për financat.

18. Përjashtohen nga qiradhënia ambientet për zyra të organeve shtetërore dhe agjencive ligjzbatuese, që lidhen me aktivitetin e peshkimit, si: Policia Kufitare dhe Migracionit, Inspektorati i Peshkimit, Shërbimi Veterinar, Dogana.

19. Organizata e Peshkimit është e detyruar të lejojë çdo mjet lundrues, që është pronë apo drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, të përdorë infrastrukturën e portit, menaxhimi i së cilës bëhet nga Organizata e Peshkimit. Në këtë rast, çdo person, i cili hyn ose shfrytëzon infrastrukturën e portit të peshkimit, që i është transferuar një organizate dhe që nuk është anëtar i saj, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e portit, planin e menaxhimit dhe me rregulloret e organizatës.

20. Organizatat e peshkimit janë të detyruara të depozitojnë në çdo kohë çdo informacion të kërkuar, si dhe të krijojnë akses për inspektimin nga përfaqësuesit e ministrisë së infrastrukturës së dhënë në menaxhim, të dokumentacionit teknik, financiar.

21. Në rastet kur në infrastrukturën e peshkimit, menaxhimi i së cilës i është transferuar Organizatës së Peshkimit, del e nevojshme kryerja e investimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndërtimin e kantiereve të riparimit të anijeve të peshkimit dhe këto investime nuk mund të realizohen nga Organizata e Peshkimit, ministria ka të drejtë t'i realizojë ato vetë ose të shpallë konkurrimin publik për palët e interesuara në kryerjen e këtyre investimeve. Në këtë rast, ministria përfshin në proces edhe Organizatën e Peshkimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

22. Kur investimet do të kryhen në zona me përparësi zhvillimin e turizmit, merret paraprakisht mendimi i ministrisë përgjegjëse për turizmin.

23. Në rastet kur, pranë ministrisë përgjegjëse për peshkimin, paraqitet njëkohësisht kërkesë nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat e peshkimit, vendimi për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit do të merret pas shqyrtimit të detajuar të planit të menaxhimit.

24. Komisioni i ngritur në ministri do të vlerësojë planet e menaxhimit sipas kritereve të mëposhtme:

i. investimet e parashikuara;

ii. plani për sigurinë e infrastrukturës;

iii. cilësia e shërbimit;

iv. kostot operative.

VI. MONITORIMI DHE SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE

1. Monitorimi i kontratave të qirasë/enfiteozës dhe i marrëveshjeve për transferimin e infrastrukturës së lidhur me peshkimin bëhet nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

2. Struktura monitoruese e kontratave të qirasë ose të enfiteozës kryen këto detyra:

a) pas lidhjes së kontratës së qirasë / enfiteozës / marrëveshjes, bën dorëzimin te qiramarrësi / enfiteozëmarrësi/pala nënshkruese me proces-verbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Në procesverbal përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira/enfiteozë/ apo transferohet me marrëveshje, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje fotografike të momentit;

b) kur mbaron afati i kontratës/marrëveshjes ose kur kontrata/marrëveshja zgjidhet/prishet para afatit, merr në dorëzim me procesverbal objektin që ka në administrim;

c) ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë/enfiteozës e kushtet e marrëveshjes dhe, çdo 6 (gjashtë) muaj, harton akte rakordimi me subjektet qiramarrëse / enfiteozëmarrëse/ nënshkruese;

ç) për çdo ndryshim në dhëniet me qira/enfiteozë/marrëveshje apo lirimin nga këto të drejta, hap pas hapi, kjo njësi njofton menjëherë ministrin;

d) krijon regjistrin për përdorim nga të tretët të pasurisë shtetërore dhe të dhënat për të ardhurat nga përdorimi i pasurisë shtetërore;

dh) mbi bazën e të dhënave të regjistrit bëjnë përmbledhësen, brenda muajit korrik, për të dhënat e gjashtëmujorit të parë, dhe, brenda muajit janar të vitit pasardhës, përmbledhësen vjetore, dhe ia paraqesin ministrit.

3. Ndaj palës kontraktuese mund të vendosen sanksione për mospërmbushje të kushteve të parashikuara në kontratë.

Për mosrealizimin e vlerës së investimit të parashikuar në kontratë, subjekti qiramarrës / enfiteozëmarrësi penalizohet me 20 (njëzet) për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Ky sanksion do të vendoset pas dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të certifikuara nga eksperti kontabël i miratuar.

4. Pala kontraktuese mund të ankimojë gjobat/penalitetet e parashikuara në kontratë ose në këtë vendim. Ministri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankimit, ka të drejtë të vendosë:

a) lënien në fuqi të gjobave/penaliteteve dhe rrëzimin e ankimit;

b) shfuqizimin/revokimin e gjobave / penaliteteve;

c) ndryshimin e aktit, duke pranuar pjesërisht ankimin për faljen e gjobave/penaliteteve.

5. Në rastet kur subjektit qiramarrës / enfiteozëmarrës/nënshkrues të marrëveshjes, për mosshlyerje të detyrimeve të parashikuara në kontratë/marrëveshje i është kërkuar zgjidhje e saj, në rast të shlyerjes së menjëhershme të këtyre detyrimeve dhe penaliteteve respektive të vendosura, ministri përgjegjës për peshkimin ka të drejtë të revokojë aktin e prishjes së kontratës / marrëveshjes së lëshuar prej tij.

6. Ministri përgjegjës për peshkimin, palë në kontratën e qirasë/enfiteozës, me kërkesën e subjektit tjetër palë në këtë kontratë, vendos për shuarjen e detyrimeve lidhur me pagesën e vlerës së qirasë, për shuarjen e penaliteteve të përcaktuara në kontratë, për zgjatjen e afateve kontraktore apo për ristrukturimin në tërësi të kontratës, për periudhën kur konstatohet:

a) shkelja e afatit njëmujor për dorëzimin e pasurisë shtetërore që jepet me qira;

b) se palët kanë qenë në konflikt administrativ apo gjyqësor, lidhur me vlefshmërinë e kontratës së qirasë/të enfiteozës;

c) pamundësia reale e qiramarrësit / enfiteozëmarrësit për posedimin, gëzimin, në mënyrë të qetë, të pasurisë shtetërore të marrë me qira/enfiteozë.

7. Të ardhurat, që krijohen nga kontrata e qirave/enfiteozës me subjekte private shkojnë në buxhetin e shtetit.

8. Të ardhurat e krijuara nga marrëveshjet e menaxhimit të lidhur me organizatat e peshkimit nga tarifat e qirasë dhe nga ofrimi i shërbimeve janë në funksion të organizatës së peshkimit për investime në infrastrukturën e transferuar dhe/ose për rritjen e shërbimeve të ofruara ndaj anëtarëve, sipas qëllimit për të cilin kjo infrastrukturë është transferuar. Çdo investim i kryer në infrastrukturë duhet të marrë më parë miratim nga ministri përgjegjës për peshkimin.

9. Penalitetet e vendosura për mosrespektim të kushteve kontraktore/të marrëveshjes shkojnë në buxhetin e shtetit.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të nxjerrë udhëzimin në zbatim të shkronjës "d", të pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Ministria e Financave dhe Ekonomisë të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 17, të kreut V, të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. _____ Rep.
Nr. _____ Kol.

DRAFT-KONTRATË
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata

Lidhur

Në Tiranë, sot më datë _____të muajit _____ të vitit (dymijë e _____), u paraqitën para meje noterit_____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfaqësuar me autorizim të ministrit, nr. _____ prot., datë ___.___.20__ nga Z. _____me detyrë_____, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datëlindjes___.___._____, banues në_____, me shtetësi shqiptare, i pajisur me letër njoftimin nr. ___, që më poshtë do të quhet "ENFITEOZËDHËNËSI/QIRADHËNËSI"

DHE

_____ me seli qendrore në _____, me adresë, _____ regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT: _____, përfaqësuar nga Z. _____, i biri i _____, i datëlindjes __.__._____, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet "ENFITOEZËMARRËSI/QIRAMARRËS".

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, mbështetur në vendimin nr._____, datë _____të Këshillit të Ministrave "_____", pas konkurrimit të zhvilluar më datë ___.___._____, në zbatim të urdhrit nr._____, datë ___.___._____ të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpalli fitues _____. Në zbatim të vendimit nr. ____, datë ___.___.20__ të Këshillit të Ministrave "_____", dhe bazuar në nenet 784–800 të Kodit Civil, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me enfiteozë "_____", sipas genplanit dhe dokumentit të ZVRPP-së _____, bashkëlidhur kontratës.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia e së drejtës për të përdorur dhe përmirësuar e objektit të përcaktuar në nenin 1, për _____.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzetë) vjet dhe pas nënshkrimit të saj nga palët, hyn në fuqi sipas pikës 9 të kreut III të VKM-së nr. ____, datë _____ 2019.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e enfiteozëdhënësit/qiradhënësit

4.1 "Enfiteozëdhënësi/qiradhënësi ", dorëzon brenda një muaji nga nënshkrimi i kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet proces-verbali i dorëzimit të objektit që jepet me enfiteozë i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Enfiteozëdhënësi/qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Enfiteozëmarrësit".

4.3 "Enfiteozëdhënësi/qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Enfiteozëdhënësi/qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Enfiteozëmarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.5 "Enfiteozëdhënësi/qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë Enfiteozëmarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e enfiteozëmarrësi/qiramarrësit

5.1 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të përmirësojë pronën e marrë me enfiteozë dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Legjislacioni Shqiptar.

5.3 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me enfiteozë, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.4 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së enfiteozës.

5.5 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së enfiteozës, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi", në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë, _____.

5.8 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi", sipas parashikimit për punësimin të shprehur sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim që, _____.

5.9 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi", në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.10 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me enfiteozë sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Enfiteozëdhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 dhe 5.8 të kësaj kontrate.

5.11 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" detyrohet të paraqesë tek "Enfiteozëdhënësi/ qiradhënësi" në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me enfiteozë.

5.12 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.13 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi ", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë.

"Enfiteozëdhënësi/qiradhënësi " nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi ", dhe që nuk mund të hiqen nga objekti pa dëmtuar atë.

Këto investime i kalojnë enfiteozëdhënësit/qiradhënësi në pronësi, pa kundërshpërblim.

5.14 Në ngarkim të "Enfiteozëmarrësit / Qiramarrësi " janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me enfiteozë.

5.15 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me enfiteozë ta japë me nënenfiteozë ose ta tjetërsojë enfiteozën te një i tretë.

5.16 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve

të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që, të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.17 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

5.18 Shitja e kuotave të aksioneve apo ndryshimi i ortakëve të shoqërisë enfiteozëmarrëse /Qiramarrëse, do të kryhet vetëm pas miratimit paraprak të "enfiteozëdhënësit/qiradhënësi".

Neni 6
Pagesa

6.1 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Enfiteozëdhënësit / qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën _____.

Pagesa _____ bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" paguan garancinë e kontratës, në _____lekë, sipas faturës së lëshuar nga "Enfiteozëdhënësi /qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.7 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Enfiteozëdhënësit/qiradhënësi" sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur "Enfiteozëmarrësi /Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 12 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Enfiteozëdhënësi/qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Enfiteozëmarrësin /Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, "Enfiteozëmarrësi /Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve.

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore.

c) kur "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.

d) kur prona nevojitet për interes publik.

e) çdo rast tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Enfiteozëdhënësit/qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim. Në rast reagimi me shkrim nga "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi", "Enfiteo-zëdhënësi/qiradhënësi", vlerëson argumentet e paraqitura dhe me pas merr vendimin përfundimtar.

Neni 9
Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Enfiteozëmarrësi / Qiramarrësi", sipas pikave 5.7, 5.8 dhe 5.9 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet njësisë së monitorimit të kontratës, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" dhe Njësia e monitorimit, janë të detyruar që çdo vit të

bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "Forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të Forcës Madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak.

Kjo periudhe do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë Plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së enfiteozësës/qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit gjyqësor _____.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

Neni 11
Detyrimi për regjistrim

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Drejtoritë Rajonale përkatëse të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Enfiteozëmarrësi/Qiramarrësi".

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa unë, noter _____, në bazë të nenit 784 e vijues, të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

ENFITEOZËDHËNËSI/ QIRADHËNËSI	ENFITEOZËMARRËSI/ QIRAMARRËSI
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Shoqëria "_____"
Përfaqësuar nga: _____	Përfaqësuar nga: _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. _____ Rep.
Nr. _____ Kol.

DRAFT-KONTRATË QIRAJE

Lidhur

Në Tiranë, sot më datë _____të muajit _____ të vitit 20__(dymijë e _____), u paraqitën para meje noterit_____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfaqësuar me autorizim të ministrit, nr. _____ prot., datë ___.___.20__ nga Z. _____me detyrë_____, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datëlindjes___.___._____, banues në_____, me shtetësi shqiptare, i pajisur me letër njoftimin nr. ___, që më poshtë do të quhet "QIRADHËNËSI"

DHE

_____ me seli qendrore në _____, me adresë, _____ regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT: _____, përfaqësuar nga Z. _____, i biri i _____, i datëlindjes __.__._____, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet "QIRAMARRËSI".

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, mbështetur në vendimin nr._____, datë _____të Këshillit të Ministrave "_____", pas konkurrimit të zhvilluar më datë ___.___._____, në zbatim të Urdhrit nr._____, datë ___.___._____ të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpalli fitues _____. Në zbatim të vendimit nr. ____, datë ___.___.20__ të Këshillit të Ministrave "_____", dhe bazuar në nenet 801-825 të Kodit Civil, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira "_____",
sipas genplanit dhe dokumentit të ZVRPP-së_____, bashkëlidhur kontratës.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për _____.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë _____ vjet dhe hyn në fuqi sipas parashikimeve të këtij vendim. .

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 "Qiradhënësi", dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet proces-verbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Legjislacioni Shqiptar.

5.3 "Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.4 "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 "Qiramarrësi", në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë, _____.

5.8 "Qiramarrësi", sipas parashikimit për punësimin të shprehur sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim që, _____.

5.9 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të

marrë përsipër sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.10 "Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 dhe 5.8 të kësaj kontrate.

5.11 "Qiramarrësi" detyrohet të paraqesë te "Qiradhënësi" në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.12 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.13 "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë.

"Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi", dhe që nuk mund të hiqen nga objekti pa dëmtuar atë.

Këto investime i kalojnë qiradhënësit në pronësi, pa kundër shpërblim.

5.14 Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.15 "Qiramarrësit" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nën qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.16 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që, të pajiset me Lejet ose Autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.17 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

5.18 Shitja e kuotave të aksioneve apo ndryshimi i ortakëve të shoqërisë qiramarrëse, do të kryhet vetëm pas miratimit paraprak të "qiradhënësit".

Neni 6
Pagesa e qirasë

6.1"Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën _____.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" paguan garancinë e kontratës, në _____lekë, sipas faturës së lëshuar nga "Qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.7 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, "Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit" sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve.

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore.

c) kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.

d) kur prona nevojitet për interes publik.

e) çdo rast tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim. Në rast reagimi me shkrim nga "Qiramarrësi", "qiradhënësi", vlerëson argumentet e paraqitura dhe me pas merr vendimin përfundimtar.

Neni 9
Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Qiramarrësi", sipas pikave 5.7, 5.8 dhe 5.9 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet njësisë së monitorimit të kontratës së qirasë, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, "Qiramarrësi" dhe Njësia e monitorimit, janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "Forcë Madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të Forcës Madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhe do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë Plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

Neni 11
Detyrimi për regjistrim

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Drejtoritë Rajonale përkatëse të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Qiramarrësit".

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi ju lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI	QIRAMARRËSI
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Shoqëria "_____"
Përfaqësuar nga: _____	Përfaqësuar nga: _____

MARRËVESHJE TIP
PËR TRANSFERIMIN E MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS TË PORTIT TË PESHKIMIT/TREGUT TË SHITJES ME SHUMICË, NDËRMJET DREJTORISË SË SHËRBIMEVE TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS DHE ORGANIZATËS SË PESHKIMIT/NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Kjo marrëveshje përbën kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore/Organizatës së Peshkimit, regjistruar si OJF me vendimin nr. ____, datë ___.___._____ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____, në kuadër të mirëfunksionimit të infrastrukturës së Portit të Peshkimit. Marrëveshja është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin" të ndryshuar si dhe vendimit nr.___, datë _._.201_, "_____".

Neni 1
Palët

Palët në këtë Marrëveshje janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe _____.

Neni 2
Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është transferimi i menaxhimit të infrastrukturës së portit të peshkimit/tregut të shitjes me shumicë, nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës tek organizata e peshkimit/njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përcaktuar kushtet për kryerjen e veprimtarive, të drejtat dhe detyrimet e Palëve.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje ndërmjet Palëve të lartpërmendura lidhet për një afat prej _____ vjetësh (jo më shumë se 20 vjet), afat i cili fillon nga momenti i nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Pronësia

4.1 Porti i peshkimit/tregu i shitjes me shumicë është pronë publike, infrastruktura e të cilit i transferohet organizatës së peshkimit.

4.2 Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës është përfaqësuesi i shtetit në marrëdhëniet e pronësisë.

Neni 5
Territori i infrastrukturës së portit që transferohet

5.1 Organizatës së peshkimit/Njësisë se Vetëqeverisjes vendore, i transferohet menaxhimi i infrastrukturës së portit të peshkimit /tregu i shitjes me shumicë, nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, mbi bazën e kufijve të përcaktuar në genplanin bashkëngjitur marrëveshjes.

5.2 Organizata e peshkimit/Njësia e vetëqeverisjes vendore garanton ruajtjen e territorit të portit të peshkimit/tregut të shitjes me shumicë.

Neni 6
Veprimtaritë kryesore që kryhen në portin e peshkimit/tregun e shitjes me shumicë

Në këtë nen do të parashikohen veprimtaritë kryesore që do të kryhen nga Njësia e vetëqeverisjes vendore/OP, në përputhje me kreun IV dhe V të vendimit të Këshillit të Ministrave që përcakton rregullat për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës lidhur me peshkimin dhe dispozitave të tjera ligjore/nënligjore që rregullojnë fushën përkatëse.

Tarifat e qirasë dhe të shërbimeve përcaktohen në përputhje me parashikimet e udhëzimit të përbashkët të ministrit të Bujqësisë dhe ministrit të Financave.

Neni 7
Ruajtja e destinacionit dhe e interesit publik

7.1 Organizata e peshkimit/Njësia e vetëqeverisjes vendore, gjatë menaxhimit të infrastrukturës së portit dhe të strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit, zbaton

kushtet e parashikuara në nenin 64, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", i ndryshuar duke garantuar:

a) mosndryshimin e destinacionit dhe qëllimit;

b) përdorimin e infrastrukturës së peshkimit nga ana e shtetit në rastet e masave të jashtëzakonshme;

c) ruajtjen dhe garantimit të interesit publik;

ç) ruajtjen dhe rritjen vlerës ekonomike të strukturave portuale të peshkimit që i janë transferuar për menaxhim, duke riparuar infrastrukturën ekzistuese, ndërtimin e infrastrukturave të reja.

Neni 8

Përgjegjësitë e organizatës së peshkimit

8.1 Organizata e peshkimit/Njësia e vetëqeverisjes vendore, duhet të përdorë infrastrukturën e transferuar, në mënyrë të drejtë e të barabartë duke iu ofruar mundësinë të gjithë anëtarëve/subjekteve private, në portin e peshkimit/tregun e shitjes me shumicë, në mënyrë që të nxisë dhe të mbrojë interesat e tyre.

8.2 Organizata e peshkimit/Njësia e vetëqeverisjes vendore merr përsipër përballimin e kostove të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së portit/tregut të shitjes me shumicë dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e tij, ku përfshihen mirëmbajtja e ndërtesave të administratës dhe të reparteve ndihmëse, shërbimet e grumbullimit të mbetjeve të ngurta apo të lëngëta të gjeneruara në territorin e portit, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, mirëmbajtja e infrastrukturës për furnizim me energji elektrike, karburante dhe ujë të pijshëm, si dhe pagesat kundrejt enteve shtetërore përkatëse, mirëmbajtja e mjediseve higjieno-sanitare të portit/tregut, mirëmbajtja e kalatave, bankinave notuese, kalunave.

8.3 Organizata e peshkimit/ Njësia e vetëqeverisjes vendore, duhet të administrojë portin e peshkimit/tregun në mënyrë racionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, për të nxitur mbrojtjen e mjedisit dhe një zhvillim të qëndrueshëm.

8.4 Organizata e peshkimit/ Njësia e vetëqeverisjes vendore, është përgjegjëse për sigurinë dhe sigurimin në territorin e portit të peshkimit/tregut që ka në menaxhim.

8.5 Organizata e peshkimit programon dhe merr masa për vendosjen e sigurt të anijeve të peshkimit në kalatë apo bankina notuese, duke respektuar rregullat dhe rregulloret e hartuara për këtë qëllim.

8.6 Organizata e peshkimit krijon kushte për përpunimin e anijeve të peshkimit në port (shkarkimin e peshkut të zënë, furnizimin me karburant, energji elektrike me ujë të pijshëm dhe bazë materiale e teknike të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit).

8.7 Tarifat e qirasë dhe të shërbimeve përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit të Bujqësisë dhe ministrit të Financave.

8.8 Të ardhurat e krijuara nga tarifat e qirasë dhe nga ofrimi i shërbimeve, në fund të vitit, nuk shpërndahen, por shërbejnë për investime në infrastrukturën e transferuar dhe/ose për rritjen e shërbimeve të ofruara, sipas qëllimit për të cilin kjo infrastrukturë është transferuar.

8.9 Çdo investim i kryer në infrastrukturë pavarësisht nga vlera duhet të marrë më parë miratim nga Ministri përgjegjës për peshkimin.

8.10 Organizatat e peshkimit/Njësia e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të raportojnë çdo 6 muaj pranë DSHPA-së lidhur me zbatimin e planit të menaxhimit, veprimtaritë e kryera, të ardhurat e realizuara etj. të shoqëruar me dokumentacion përkatës provues.

8.11 Organizatat e peshkimit/Njësia e vetëqeverisjes vendore, janë të detyruara të depozitojnë në çdo kohë çdo informacion të kërkuar, si dhe të krijojë akses për inspektimin nga përfaqësuesit e ministrisë, të dokumentacionit teknik, financiar.

Neni 9

Të drejta dhe përgjegjësitë e palës shtetërore

9.1 Pala shtetërore, e ngarkuar nga legjislacionin në fuqi, ka të drejtë të inspektojë infrastrukturën e transferuar si dhe dokumentacionin përkatës.

9.2 Ministria është përgjegjëse për sa parashikohet bazuar në shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", i ndryshuar.

Neni 10
Inspektimi

Organizata e peshkimit/Njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të krijojë të gjitha kushtet për inspektimin nga ana e organeve shtetërore, të ngarkuara nga ligji, të portit dhe të strukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit që ajo administron.

Neni 11
Marrëdhëniet e organizatës së peshkimit me organet shtetërore[3]

11.1. Marrëdhëniet e organizatës së peshkimit me organet shtetërore rregullohen sipas parashikimeve të nenit 64 të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", i ndryshuar.

11.2 Kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrës së kapitanerisë së portit ndaj anijeve të peshkimit, ekuipazheve të tyre dhe koordinimit të veprimtarive të lundrimit rregullohen mbi bazën e ligjeve në fuqi dhe të Kodit Detar. Organizata e peshkimit bashkëpunon me kapitanerinë si në drejtim të këmbimit të informacionit të mbërritjes e largimit të anijeve, ashtu edhe për lëvizjen e anijeve brenda portit.

11.3 Organizata e peshkimit bashkëpunon me kapitanerinë dhe regjistrin detar për ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve që lidhen me sigurimin e lundrimit të anijeve mbi bazën e konventave ndërkombëtare.

11.4 Organizata e peshkimit bashkëpunon dhe i krijon kushtet e duhura doganës në mënyrë që ajo të kryejë detyrat funksionale të saj brenda territorit të portit të peshkimit.

11.5 Organizata e peshkimit bashkëpunon me policinë kufitare dhe migracionit, me qëllim që të sigurojë zhvillimin normal të veprimtarive në portin e peshkimit.

Neni 12
Dokumentacioni

12.1 Dokumentacioni i procedurës së transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së portit të peshkimit/tregut të shitjes me shumicë, mbahet në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe një kopje të saj i dërgohen dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

12.2 Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe OP-ja/ Njësia e vetëqeverisjes vendore, kryejnë inventarin e portit të peshkimit/ tregut, të cilin e merr në ngarkim së bashku me dokumentacionet përkatëse.

Neni 13
Mbarimi i marrëveshjes

13.1 Kjo marrëveshje mbaron kur përfundon afati i përcaktuar në nenin 3 të saj;

13.2 Kjo marrëveshje mbaron para afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj, kur:

a) në përfundim të vitit të parë të zbatimit të Marrëveshjes, në varësi të performancës së organizatës së peshkimit/njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe efektivitetit ekonomik, ministria zgjidh në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen. Në këtë rast, ministria nuk mban përgjegjësi ligjore, përfshirë edhe përgjegjësi financiare, ndaj OP-së/Njësisë së vetëqeverisjes vendore;

b) organizata e peshkimit shpërndahet;

c) organizata e peshkimit/Njësia e vetëqeverisjes vendore, ndryshon destinacionin dhe qëllimin e përdorimit të portit/tregut, të përcaktuar sipas kësaj Marrëveshjeje;

d) organizata e peshkimit/Njësia e vetëqeverisjes vendore, nuk merr përsipër të vazhdojë administrimin e portit/tregut, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

e) organizata e peshkimit/ Njësia e vetëqeverisjes vendore, shkel parashikimet e ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", i ndryshuar, legjislacionit në fuqi të aplikueshëm në menaxhimin e infrastrukturës dhe/ose në funksionimin e tregjeve me shumicë, detyrimet e marrëveshjes, ose dështon në përmbushjen e kushteve të planit të menaxhimit.

Neni 14
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

14.1 Palët respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet, të cilat mund të lindin gjatë zbatimit të saj, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.

14.2 Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë

[3] Kjo dispozitë aplikohet vetëm për OP-të.

një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.

14.3 Personat e autorizuar të palëve të përfshira në mosmarrëveshje duhet të bëjnë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.

14.4 Nëse personat e autorizuar të palëve apo përfaqësuesit e tyre nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.

14.5 Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbikëqyren dhe aprovohen nga ministria.

14.6 Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë _____.

Neni 15
Të ndryshme

15.1 Kjo Marrëveshje nënshkruhet në 4 kopje origjinale, nga të cilat tri depozitohen në ministri dhe një tek organizata e peshkimit.

15.2 Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje duhet të negociohet ndërmjet palëve dhe të bëhet me shkrim.

15.3 Në këtë rast të mospërputhjeve ndërmjet parashikimeve të marrëveshjes dhe parashikimeve të ligjit dhe/ose vendimit nr._____, datë___.____.____, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit, tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private", do të konsiderohet se mbizotërojnë parashikimet e ligjit dhe/ose vendimit.

15.4 Të gjitha kushtet e parashikuara në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", i ndryshuar, legjislacionin tjetër në fuqi të aplikueshëm në menaxhimin e infrastrukturës, dhe vendimin, "Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit, tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private", janë drejtpërdrejt të zbatueshme në këtë marrëveshje.

PALËT NËNSHKRUESE

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Përfaqësuar nga:

_____

Shoqëria "_____"

Përfaqësuar nga:

_____

VENDIM
Nr. 348, datë 22.5.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË, PËR BASHKËPUNIM NË TURIZËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për bashkëpunim në turizëm, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
PËR BASHKËPUNIM NË TURIZËM
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Serbisë, në vijim të referuara si "Palët",

Në interes të përbashkët për zhvillimin e bashkëpunimit në kuadër të turizmit mes dy shteteve,

Duke vlerësuar rolin e dialogut dhe konsultimeve në nivele të ndryshme ndërmjet Palëve për çështjet me interes të përbashkët,

Duke njohur interesat e përbashkëta në përcaktimin e kuadrit ligjor të mjaftueshëm dhe afatgjatë për bashkëpunimin në fushën e turizmit,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët, në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe brenda aftësive të tyre të përshtatshme të dy vendeve, do të nxisin dhe do të mbajnë bashkëpunim reciprok mes organeve shtetërore kompetente, organizatave, dhe institucioneve të tjera përkatëse të të dyja vendeve në fushën e turizmit dhe për këtë qëllim do të miratojnë masat e duhura.

Palët do të nxisin shkëmbimin e ndërsjellë dhe do të inkurajojnë udhëtimet turistike nga vendet e treta.

Neni 2

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e ndërsjellë të statistikave të turizmit dhe të informacionit, programeve arsimore, aftësimit profesional të personelit, si dhe studime dhe projekte kërkimore në fushën e turizmit.

Palët, në përputhje me legjislacionin dhe Brenda kompetencave të tyre, do të përmirësojnë bashkëpunimin në mes të autoriteteve dhe institucioneve kompetente në fushën e formimit profesional të personelit në turizëm dhe në shkëmbimin e ekspertëve të turizmit.

Neni 3

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e materialeve promovuese në fushën e bashkëpunimit në turizëm, në rastin e paraqitjes në eventet e turizmit në të dy vendet.

Neni 4

Palët do të inkurajojnë dhe mbështesin organizimin e vizitave studimore për përfaqësues të mediave dhe profesionistë turistik.

Palët, në përputhje me legjislacionin e tyre, mbi bazë reciproke, inkurajojnë organizimin e ekspozitave, ngjarjeve, prezantimin e filmit turistik, në mënyrë që të paraqesin ofertën turistike.

Neni 5

Palët do të kushtojnë vëmendje të veçantë zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë së ofertës turistike dhe shkëmbimit të informacionit në mënyrë që të krijojnë dhe realizojnë projekte me interes të përbashkët.

Palët do të inkurajojnë organizimin e takimeve për biznesin dhe profesionistë në kuadër të turizmit, në mënyrë që të sigurojnë mundësi për prezantimin e informacionit, të dhëna statistikore, dokumentacionin dhe shkëmbimin e përvojave profesionale në fushën e turizmit.

Neni 6

Palët do të koordinojnë bashkëpunimin e turizmit në përputhje me rekomandimet e Organizatës Botërore të Turizmit dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare.

Palët do të informojnë secilën mbi të gjithë dokumentet ndërkombëtare në fushën e turizmit që mund të jetë me interes për bashkëpunimin mes tyre.

Neni 7

Palët, në përputhje me rregulloret e saj të brendshme, inkurajojnë krijimin e qendrave kombëtare të informacionit turistik në territorin e Palës tjetër dhe ndihmojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për organizmin dhe kryerjen e aktiviteteve.

Neni 8

Palët kanë rënë dakord të krijojnë një Komision të Përbashkët për Turizmin, i përbërë nga numër i barabartë përfaqësuesish të Palëve, në mënyrë që të arrihen objektivat e kësaj marrëveshje. Komisioni për Turizmin do të mblidhet të paktën një herë në vit, i alternuar në secilën nga Palët. Komisioni për Turizmin kryesisht është:

- sigurimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje;
- monitorimin dhe analizimin e rezultateve të bashkëpunimit në periudhën e mëparshme;
- sigurimin e shkëmbimit të informacionit në lidhje me ndryshimin e rregulloret e në secilën prej Palëve, të cilat janë të lidhura me turizmin dhe kryerjen e aktiviteteve turistike;
- rekomandimin e veprimeve specifike dhe formave të tjera të bashkëpunimit të ndërsjellë në të ardhmen.

Neni 9

Kur është e nevojshme, palët mund të lidhin Protokollet për të zbatuar për Marrëveshje.

Neni 10

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e njoftimit të fundit me, nëpërmjet të cilës secila Palë informon Palën tjetër mbi përfundimin e procedurave të nevojshme integrale ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vite. Vlefshmëria e saj do të shtyhet automatikisht për 5 (pesë) vite të ardhshme, me kusht që asnjë nga Palët njofton me shkrim Palën tjetër, të paktën gjashtë muaj para mbarimit të kësaj Marrëveshjeje, qëllimin e saj për të denoncuar këtë Marrëveshje.

Njoftimi i denoncimit të kësaj Marrëveshjeje nga njëra nga Palët nuk do të ndikojë në zbatimin e aktiviteteve të filluara para denoncimit të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse Palët bien dakord ndryshe.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve, në përputhje me paragrafin 1, të nenit 10.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi "Për bashkëpunimin në fushën e turizmit", nënshkruar në Tiranë, më 22 dhjetor 2004 dhe hyrë në fuqi më 28 dhjetor 2005, do të pushojë të jetë e vlefshme.

Nënshkruar në 15.5.2018 mbi Beograd Serbi, në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet me përmbajtje të njëjtë.

Në rast mosmarrëveshjesh në interpretim ose zbatim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës së Serbisë

UDHËZIM
Nr. 12, datë 20.5.2019

PËR MASAT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2019

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të vendimit të Këshillit Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, të vendimit të Këshillit Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.9.2017, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

UDHËZOJ:

KREU I
PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE 2019

1. Për provimet e Maturës Shtetërore 2019 ndiqen procedurat e përcaktuara në urdhrin nr. 780, datë 23.11.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2019 në Republikën e Shqipërisë".

2. Periudhat kohore të ekspozimit potencial të sekretit (KOEPS) për Maturën Shtetërore 2019, të jenë:

a) 1 qershor – 7 qershor 2019;

b) 7 qershor – 12 qershor 2019;

c) 12 qershor – 17 qershor 2019;

d) 17 qershor – 24 qershor 2019.

3. Përzgjedhja e testeve përfundimtare të provimeve të Maturës Shtetërore do të bëhet përmes teknologjisë digjitale dhe mbahet procesverbali përkatës lidhur me procedurën e ndjekur.

4. Lista e punonjësve të QSHA-së, të cilët përfshihen në KOEPS për secilën periudhë të përmendur në pikën 2 të këtij udhëzimi, miratohet nga drejtori i përgjithshëm i QSHA-së.

5. Specialistët e lëndëve përkatëse të QSHA-së kanë për detyrë të hartojnë skemat e vlerësimit të testeve dhe ndihmojnë më tej në proceset e formatimit, shumëfishimit dhe shpërndarjes së tyre.

6. Pas zhvillimit të çdo provimi, testet dërgohen nga shërbimi postar në masa sigurie në godinën e shkollës 9-vjeçare "1 Maji", Tiranë, mjediset e gjimnazit "Ismail Qemali", Tiranë. QSHA-ja kryen inventarizimin dhe shpërndarjen e tyre në qendrat e vlerësimit.

7. Vlerësimi i testeve do të bëhet në qendrat e vlerësimit të mëposhtme:

a) në Tiranë, në godinën e shkollës 9-vjeçare "1 Maji", qendra nr. 1;

b) në Tiranë, në godinën e gjimnazit "Ismail Qemali", qendra nr. 2;

c) në Elbasan, në godinën e shkollës "Vasil Kamami".

8. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar Tiranë dhe Elbasan, të marrin masa për lirimin e mjediseve për vlerësimin e testeve në godinat e sipërpërmendura, të cilat do të ruhen me shërbim 24-orësh nga Policia e Shtetit, gjatë periudhës 8 qershor deri më 2 korrik 2019.

9. Transporti i testeve nga Tirana për në qendrën e vlerësimit Elbasan dhe anasjelltas, të bëhet me automjetet e IAVPAP-ve përkatëse dhe nga grupi monitorues, të përmendur në pikën 16, të këtij udhëzimi, nën masa të rrepta sigurie.

KREU II
MONITORIMI I PROCESIT TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2019

10. IAVPAP–të të marrin të gjitha masat për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e aparaturave të bllokimit/zhurmimit të mjeteve të komunikimit elektronik dhe përdorimit të detektorëve.

a) Një grup i ngritur me urdhër të drejtuesit të IAVPAP-së përkatëse i vendos këto aparatura në vende që sigurojnë bllokimin/zhurmimin e valëve të mjeteve të komunikimit elektronik në çdo mjedis të provimit.

b) Çdo IAVPAP trajnon përgjegjësit e administrimit të provimeve (PAP) dhe përgjegjësit e kateve (PK) për përdorimin efektiv të detektorëve për çdo qendër provimi.

c) Kontrolli me detektor ushtrohet mbi maturantët/kandidatët dhe të gjithë personat që merren me administrimin e provimit.

11. Drejtuesit në çdo IAVPAP përgjigjen për mirëfunksionimin e aparaturave të bllokimit/zhurmimit të mjeteve të komunikimit elektronik dhe përdorimit të detektorëve.

12. PAP-i dhe përfaqësuesit e MASR-së në ditën e provimit kujdesen në mënyrë të vazhdueshme që detektorët dhe aparaturat e bllokimit/zhurmimit të jenë në gjendje pune.

13. Çdo neglizhencë ndaj detyrimit për mirëfunksionimin e aparaturave të bllokimit/zhurmimit ngarkon me përgjegjësi administrative dhe përgjegjësi të parashikuara nga Kodi Penal drejtuesit në IAVPAP, PAP dhe PK.

14. Drejtuesit e IAVPAP-eve dërgojnë zyrtarisht, një ditë përpara çdo provimi, listën dhe vendndodhjen e qendrave të provimit te drejtuesit rajonalë të OSHEE-së, në mënyrë që të merren masat e nevojshme për furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike të këtyre qendrave.

KREU III
MONITORIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË TESTEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2019

15. Pas çdo provimi, në secilën nga qendrat e vlerësimit të provimeve të Maturës Shtetërore të funksionojë në mënyrë të vazhdueshme një grup i

administrimit dhe monitorimit të procesit të vlerësimit të testeve me përbërje si më poshtë:

a) një përfaqësues i QSHA-së;

b) një përfaqësues i MASR-së ose i ASCAP-it;

c) një përfaqësues i IAVPAP-së përkatëse.

16. Grupi monitorues në qendrën e vlerësimit ka detyrat si vijon:

a) Përgjigjet për tërheqjen e testeve në QSHA dhe për transportin e tyre drejt qendrës së vlerësimit.

b) Merr në dorëzim testet, me procesverbal që nënshkruhet nga tre përfaqësuesit e grupit monitorues, si dhe nga përfaqësuesi i QSHA-së, i cili bën dorëzimin e tyre.

c) Kontrollon nëse është siguruar ruajtja nga policia e objektit ku do të zhvillohet procesi i vlerësimit të testeve.

d) Qëndron në mjediset e qendrës së vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit dhe raporton në institucionet përkatëse.

17. Personat që bëjnë pjesë në grupet e monitorimit të procesit të vlerësimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2019 për secilën qendër vlerësimi, caktohen nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

18. Periudha e monitorimit dhe grafiku i paraqitjes së përfaqësuesve të grupit monitorues në QSHA, është:

a) për lëndën "Gjuhë e huaj": 9–16 qershor 2019,

b) për lëndën "Gjuhë dhe letërsi shqipe": 14–21 qershor 2019,

c) për lëndën "Matematikë": 19–26 qershor 2019,

d) për lëndët me zgjedhje: 26–2 korrik 2019.

19. Për drejtimin dhe mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit, QSHA-ja të caktojë në çdo qendër dhe për secilin provim dy specialistë, të cilët do të përzgjidhen dhe trajnohen prej saj.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

20. Punonjësit që angazhohen jashtë kohës normale të punës në procesin e administrimit dhe vlerësimit të testeve të Maturës Shtetërore 2019, të paguhen sipas akteve nënligjore në fuqi.

21. Shpenzimet e udhëtimit, hotelit dhe ushqimit të punonjësve të përfshirë në proces mbulohen nga institucionet përkatëse.

22. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Komiteti i Maturës Shtetërore dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

UDHËZIM
Nr. 402, datë 14.5.2019

PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT TË MJEKËVE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NËPËRMJET PLATFORMËS ELEKTRONIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 dhe të nenit 199, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale",

UDHËZOJ:

KREU 1
TË PËRGJITHSHME

1. Procedurat për punësimin e mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, barazisë dhe interesit më të lartë të shëndetit publik.

2. Procedurat administrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OShKSh) dhe institucionet shëndetësore.

3. Për të marrë pjesë në Programin e Bonusit mjeku specialist aplikon përmes platformës elektronike "Mjekë për Shqipërinë".

4. Procesi i konkurrimit zhvillohet për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin për ushtrimin e profesionit të mjekut, si dhe kriteret specifike të pozicionit të punës.

5. Kandidatët e interesuar për t'u punësuar si mjekë në institucionet shëndetësore publike marrin pjesë në konkurrimin, i cili zhvillohet në dy faza:

a) konkurrimi me dosje;

b) intervista.

KREU II
SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS DHE APLIKIMI

1. Institucionet shëndetësore publike në varësi të OSHKSH-së, raportojnë vendet e lira të punës që krijohen pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së.

a) Drejtoritë rajonale të OSHKSH-së analizojnë nevojën për pozicionin e punës (mjek) të mbetur vakant, nëse vlerësohet se për këtë pozicion nuk plotësohet ngarkesa e punës dhe është i panevojshëm për institucionin, deklarohet në ministri si pozicion tepër.

b) Për pozicionet mjek të mbetura vakant, për të cilat do të hapen procedurat e konkurrimit, drejtoritë rajonale të OSHKSH-së përgatisin listën sipas institucioneve shëndetësore publike, njoftojnë Drejtorinë Qendrore të OSHKSH-së dhe të MSHMS-së, si dhe shpallin vendet vakante në portalin "Mjek për Shqipërinë".

2. Qendrat spitalore universitare identifikojnë vendet vakant për mjek sipas shërbimeve dhe përgatisin listat me vendet e lira. Qendrat spitalore universitare njoftojnë MSHMS për vendet e lira të krijuara dhe shpallin vendet vakant në portalin "Mjek për Shqipërinë.

3. Kandidatët e interesuar dërgojnë në portalin "Mjekë për Shqipërinë" dosjen e aplikimit për konkurrim.

4. Afati i aplikimit është jo më pak se dy javë kalendarike nga data e shpalljes së vendit vakant.

5. Dosja e aplikimit përmban:

a) jetëshkrimin e kandidatit (CV) (i detyrueshëm);

b) librezën e punës;

c) diplomën universitare dhe listën e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (e detyrueshme);

d) diplomën e specializimit dhe listës së notave (e detyrueshme nëse pozicioni i punës është për mjek specialist);

e) lejen e ushtrimit të profesionit (e detyrueshme);

f) dëshmi të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor);

g) dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja;

h) certifikatat e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim të ndjekura brenda dhe jashtë vendit;

i) deklaratë për gjendjen gjyqësore (e detyrueshme) sipas shtojcës 3;

j) raporti mjeko-ligjor i tre muajve të fundit (i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës).

6. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme si më sipër, skualifikohet.

7. Kandidatët të cilët janë të punësuar në një institucion shëndetësor publik nuk mund të konkurrojnë nëpërmjet kësaj platforme, për ata do të zbatohen procedurat e transferimit.

KREU III
KONKURRIMI DHE EMËRIMI

1. Kandidatët do të vlerësohen për diplomën, gjuhën e huaj, përvojën në shëndetësi, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për intervistën me gojë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 50 pikë, përkatësisht:

a) deri në 45 pikë vlerësimi i dosjes;

b) deri në 5 pikë vlerësimi i intervistës me gojë.

2. Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, përcaktohet në shtojcën 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Komisioni i Vlerësimit, brenda pesë ditëve pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe brenda dy ditëve njofton datën për intervistën me gojë.

4. Komisioni i Vlerësimit në ditën e intervistës përgatit pyetjet të cilat duhet të jenë të njëjta për të gjithë kandidatët.

5. Në përfundim, Komisioni i Vlerësimit harton listën me pikët totale për çdo kandidat dhe i

njofton ata për rezultatin nëpërmjet adresës së tyre me e-mail.

6. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit për rezultatin brenda tri ditëve nga dita e njoftimit të tyre. Ankesa bëhet përmes portalit "Mjekë për Shqipërinë" në adresën e kontaktit që do të jetë te shpallja e vendit vakant.

7. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankimuesit me shkrim ose sipas formës që do të dakordësohet.

8. Pas përfundimit të afateve të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Vlerësimit shpall renditjen e kandidatëve në portalin "Mjekë për Shqipërinë", sipas pozicioneve vakante dhe dërgon emrat e fituesve/fituesin pranë Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së ose institucioneve qendrore shëndetësore".

9. Përkatësisht, Drejtoria Rajonale e OSHKSH-së të rajonit përkatës ose qendrat spitalore universitare nxjerrin aktin e emërimit për fituesin. Kandidati i shpallur fitues lidh kontratë individuale pune me institucionin shëndetësor.

10. Kandidatët për të cilët nuk ka një vend vakant, qëndrojnë në listën e pritjes për një vend pune deri në shpalljen e radhës.

11. Drejtoritë rajonale të OSHKSH-së dërgojnë listën me emrat e fituesve pranë Drejtorisë Qendrore të OSHKSH-së dhe Ministrisë, gjithashtu, spitalet qendrore universitare dërgojnë listën me emrat e fituesve pranë MSHMS-së.

KREU IV
KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. Drejtoritë rajonale të OSHKSH-së dhe drejtoritë e spitaleve qendrore universitare, respektivisht, krijojnë komisionet e vlerësimit *ad hoc* për vlerësimin e kandidatëve që marrin pjesë në konkurrim.

2. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë:

a) drejtoritë rajonale të OSHKSH-së krijojnë komisionet *ad hoc* për vlerësimin e kandidatëve për mjek në spitalet rajonale e bashkiake/njësitë vendore të kujdesit shëndetësor dhe në qendrat shëndetësore, përkatësisht, një anëtar nga institucioni (spital/NJVKSH), një anëtar nga Drejtoria Rajonale e OSHKSH-së, një anëtar nga Drejtoria Qendrore e OSHKSH-së, anëtari i Drejtorisë Rajonale të OSHKSH-së është kryetar i komisionit.

b) Spitalet qendrore universitare krijojnë komisionet *ad hoc* për vlerësimin e kandidatëve për mjek në institucionet respektive, të paktën njëri nga anëtarët të jetë përfaqësues i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.

3. Anëtarët e Komisionit duhet të verifikojnë dhe të shmangin konfliktin e interesit me kandidatët (shtojca 4).

4. Komisioni është përgjegjës, për:

a) vlerësimin e dosjes së çdo kandidati, sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim;

b) intervistimin e kandidatëve;

c) njoftimin e kandidatëve për pikët e vlerësimit;

d) shqyrtimin e ankesave dhe kthimin e përgjigjeve;

e) renditjen përfundimtare të kandidatëve dhe shpalljen e tyre;

f) dërgimin e procesverbaleve dhe materialeve të tjera të konkurrimit pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së apo institucionit qendror përkatës.

KREU V
PLOTËSIMI I VENDEVE VAKANTE NËPËRMJET PROGRAMIT TË BONUSIT

1. MSHMS-ja shpall vendet vakant për mjek specialist në spitalet rajonale/bashkiake për të cilat do të aplikohet Programi i Bonusit.

2. Kandidatët që aplikojnë në Programin e Bonusit duhet të jenë të punësuar në institucionet shëndetësore publike.

3. Për aplikim nevojitet:

a) kërkesa për shprehje interesi;

b) vërtetimi i punësimit nga institucioni shëndetësor ku punon, si dhe leje nga institucioni për pjesëmarrje në Programin e Bonusit;

c) diploma e specialitetit.

4. MSHMS-ja krijon Komisionin e Vlerësimit për aplikantët në Programin e Bonusit. Komisioni i vlerësimit administron dokumentet e aplikantëve, zhvillon intervistën me kandidatët dhe zgjedh fituesin.

5. Mjeku specialist, që fiton nga Programi i Bonusit, lidh kontratë me MSHMS-në, me institucionin shëndetësor ku do të punojë dhe me drejtorinë rajonale të FSDKSH-së.

6. Në përfundim të kontratës, mjeku specialist kthehet në vendin e mëparshëm të punës.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra në zbatimin e këtij udhëzimi ruhen pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së ose institucionit qendror shëndetësor dhe janë objekt verifikimi nga MSHMS-ja.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi MSHMS-ja, Drejtoria Qendrore dhe drejtoritë rajonale të OSHKSH-së, si dhe institucionet shëndetësore publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT TË DOSJES PËR KANDIDATËT: MJEKË DHE MJEKË SPECIALISTË

1. Nota mesatare e studimeve të larta (shprehur në numër dhe një shifër pas presjes dhjetore):

5–10 pikë.

2. Nota mesatare e specializimit (shprehur në numër dhe një shifër pas presjes dhjetore):

5–10 pikë.

3. Njohja e gjuhëve të huaja: maksimumi 3 pikë:

Mbrojtja e një gjuhe të huaj vlerësohet me: 1 pikë;

Për kandidatët që kanë studiuar jashtë Shqipërisë, mbrojtja e gjuhës së huaj nuk ka nevojë të provohet me dëshmi.

4. Grada shkencore: maksimumi 5 pikë:

Studime doktorature në shëndetësi: 5 pikë;

Kur doktoratura nuk lidhet me specializimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, vlerësohet me: 2 pikë;

Studime master në menaxhim shëndetësor: 2 pikë;

5. Eksperienca në profesion: 1 pikë për çdo vit punë, deri në 10 vite.

6. Diploma dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën: maksimumi 7 pikë:

a) trajnime dhe kualifikime me kohëzgjatje dy javë deri në tre muaj: 1 pikë;

b) kualifikime nga 3 deri në 6 muaj: 2 pikë;

c) kualifikime 6 muaj e më shumë: 3 pikë.

SHTOJCA 2
DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaroj, në përgjegjësinë time, se në procesin e konkurrimit për pozicionin mjek pranë _____ që do të zhvillohet në datën _____, nuk jam në konflikt interesi me asnjë prej kandidaturave të paraqitura për konkurrim.

DEKLARUESI

DATA

SHTOJCA 3
DEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit;

Emër, atësi, mbiemër:

Datëlindja:

Vendlindja:

Dokumenti i identifikimit: (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam; i/e padënuar i/e dënuar

Emër, mbiemër: Firmë:

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

VENDIM
Nr. 607, datë 21.5.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE, QARKU GJIROKASTËR, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 21.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;
Denar Biba: zv.kryetar;
Bledar Skënderi: anëtar;
Edlira Jorgaqi: anëtare;
Rezarta Bitri: anëtare,

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Gjirokastër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Flamur Sejdi Golemi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 1981/1 prot., datë 13.5.2018, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit të zonës zgjedhore, qarku Gjirokastër.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Gjirokastër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 3 (tri) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, qarku Gjirokastër, janë numri rendor 1 (një) z. Bledar Triumf Çuçi, numri rendor 2 (dy) znj. Mirela Mentor Kumbaro (Furxhi), numri rendor 3 (tre) z. Flamur Sejdi Golemi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste, qarku Gjirokastër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumemërore me numër rendor 4 (katër) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 400, datë 15.5.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumemërore me numër rendor 5 (pesë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Znj. Artemis Kosta Dralo (Malo), referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin

Qendror të Zgjedhjeve, më datë 14.5.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 4160.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të znj. Artemis Kosta Dralo (Malo), rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b", dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2655 prot., datë 16.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3656 prot., datë 16.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Gjirokastër, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Artemis Kosta Dralo (Malo).

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1515/1 prot., datë 17.5.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Gjirokastër, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Artemis Kosta Dralo (Malo), sipas së cilës rezulton e padënuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i dokumentacionit (të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe vërtetimit të gjendjes gjyqësore) sipas nenit 2 dhe nenit 4, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", rrethanat e paraqitura nga znj. Artemis Kosta Dralo (Malo), nuk përfshihen në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t'u zgjedhur në funksionin e deputetit.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumemërore e Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore qarku Gjirokastër, i renditur me numër rendor 5 (pesë), znj. Artemis Kosta Dralo (Malo).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Gjirokastër, znj. Artemis Kosta Dralo (Malo).

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

KËRKESË
Nr. 5277/1, datë 22.5.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga e ARBRIT".

Subjekti kërkues i këtij projekti është ARRSH.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,768,919 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

Lista paraprake e pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit:

Ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga e ARBRIT"

Çmimi për pasurinë e llojit tokë arë dhe truall janë sipas VKM nr. 89, datë 03.02.2016.

N/R	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas zvrpp)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË						VLERA TOTALE (Lekë)	RRETHI	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pasurisë	Lloji. Pasurisë	Sip. Totale (m2)	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"					
								Sip.e prekur (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera në (lekë)	Sip.e prekur (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera në (lekë)			
1	LAVDRIM MIRVETE	RAMADAN TAHIR	JOLLA	2592	759/1	ARE	1770	138.6	115	15,939.00				15,939.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
2	BP. NURÇE			2592	759/2	ARE+TRUALL+NDERTESE	2102	446	115	51,290.00				51,290.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
3	MUSTAFA	VEHAP	SHEHU	2592	552/1	ARE	14085	529	115	60,835.00				60,835.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
4	HAJRI	VEHAP	SHEHU	2592	552/2	ARE	14142	637	115	73,255.00				73,255.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
5	HAJRI	VEHAP	SHEHU	2592	552/3	ARE	2006	103	115	11,845.00				11,845.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
6	HAXHI	SHABAN	TOMJA	2592	547/1	ARE	312	160	115	18,400.00				18,400.00	DIBËR	Konf. ZVRPP. Kufizime ne Seksionin E te Karteles se Pasurise.
7	HYSNIJE LUAN	DALI HAZIS	GJONI	2592	547/3	ARE	270	128	115	14,720.00				14,720.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
8	XHAMIA			2592	541	ARE	3007	363	115	41,745.00				41,745.00	DIBËR	Konf. ZVRPP. Kufizime ne Seksionin E te Karteles se Pasurise.
9	HASHIM	XHETAN	KESHI	2592	540/5	TRUALL + NDERTESE	2500				488	140	68,320.00	68,320.00	DIBËR	Konf. ZVRPP. Kufizime ne Seksionin E te Karteles se Pasurise.
10	BP MUÇA			2592	591/7	ARE	1550	313	115	35,995.00				35,995.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
11	BARDHYL	MEHMET	GJONI	2592	591/3	ARE	1040	468	115	53,820.00				53,820.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
12	BP GJONI			2592	598	ARE	3800	313	115	35,995.00				35,995.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
13	PRONAR I PA VERTETUAR			2592	682/1	TRUALL+ NDERTESE	240				24	140	3,360.00	3,360.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
14	DYLBER	ISUF	KOSIQI	2592	682	ARE	4127	243	115	27,945.00				27,945.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
15	BP SHTREZI			2592	681	ARE	2980	226	115	25,990.00				25,990.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
16	BP ABAZI			2592	676	ARE	5849	1108	115	127,420.00				127,420.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
17	ILJAZ	OSMAN	MUÇA	1224	1/1	ARE	2500	359	115	41,285.00				41,285.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
18	SHABAN	DALIP	MUÇA	1224	1/2	ARE	1250	254	115	29,210.00				29,210.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
19	BP MUÇA			1224	1/3	ARE	1250	188	115	21,620.00				21,620.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
20	RASIM	DILAVER	VELIU	1224	2/2	ARE	1760	34	115	3,910.00				3,910.00	DIBËR	Konf. ZVRPP. Kufizime ne Seksionin E te Karteles se Pasurise.

21	SADULLA	DILAVER	VELIU	1224	2	ARE	1766	610	115	70,150.00				70,150.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
22	LAVDI	SALI	HASA	1224	3/1	ARE	2375	22	115	2,530.00				2,530.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
23	XHELIL	SALI	HASA	1224	3	ARE	2375	409	115	47,035.00				47,035.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
24	RIFAT	QAMIL	HASA	1224	24	ARE	3000	459	115	52,785.00				52,785.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
25	MEHMET	QAMIL	HASA	1224	28	ARE	3000	348	115	40,020.00				40,020.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
26	LUTFI	ZENEL	TROCA	1224	29	ARE	4500	286	115	32,890.00				32,890.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
27	ILAZ	OSMAN	MUÇA	1224	30/1	ARE	2250	132	115	15,180.00				15,180.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
28	SHABAN	DALIP	MUÇA	1224	30/2	ARE	1125	151	115	17,365.00				17,365.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
29	BP MUÇA, etj			1224	30/3	ARE	1125	153	115	17,595.00				17,595.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
30	ILIAZ	OSMAN	MUÇA	1224	31	ARE	5150	807	115	92,805.00				92,805.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
31	MEHMET	LIMAN	TURJA	1224	22	ARE	2375	107	115	12,305.00				12,305.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
32	SADULLA	DILAVER	VELIU	1224	23	ARE	3620	161	115	18,515.00				18,515.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
33	DESTAN	HAZIZ	MUÇA	1225	1/1	ARE	3100	376	115	43,240.00				43,240.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
34	RAMAZAN	MUSLI	ÇALLAKU	1225	2/1	ARE	2000	65	115	7,475.00				7,475.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
35	RINO	RUSTEM	DEDA	1225	2/2	ARE	2000	77	115	8,855.00				8,855.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
36	RAZI	PETRIT	ALLÇISHT	1225	2/3	ARE	2000	128	115	14,720.00				14,720.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
37	HAJRI	HASAN	CAPA	1225	3/1	ARE	3108	80	115	9,200.00				9,200.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
38	TONI	NAZIF	ALLÇISHT	1225	3/3	ARE	5842	298	115	34,270.00				34,270.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
39	HAJRI	HASAN	CAPA	1225	3/4	ARE	1800	23	115	2,645.00				2,645.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
40	RRUZHDI	RAMADAN	MUÇA	1225	18	ARE	2200	494	115	56,810.00				56,810.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
41	IYZI	RAMADAN	MUÇA	1225	26	ARE	2000	931	115	107,065.00				107,065.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
42	IYZI	RAMADAN	MUÇA	1225	21	ARE	600	15	115	1,725.00				1,725.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
43	XHEVIT	HALIT	MUÇA	1225	22	ARE	532	55	115	6,325.00				6,325.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
44	MUZAFER	HAKI	MUÇA	1225	24	ARE	480	121	115	13,915.00				13,915.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
45	SINAN	SABEDIN	MUÇA	1225	25	ARE	560	124	115	14,260.00				14,260.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
46	RIZA	HALIT	MUÇA	1225	147	ARE	1280	697	115	80,155.00				80,155.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
47	XHEVIT	HALIT	MUÇA	1225	146	ARE	1512	1512	115	173,880.00				173,880.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
48	RIZA	HALIT	MUÇA	1225	23	ARE	504	107	115	12,305.00				12,305.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
	SHUMA							**14758.6**		**1,697,239.00**	**512**		**71,680.00**	**1,768,919.00**		

NJOFTIM
Nr. 7373, datë 20.5.2019

PËR HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Polonisë për punësimin në punë fitimprurëse të anëtarëve të familjes së një anëtari të një misioni diplomatik apo konsullor, hyn në fuqi në datën 6 qershor 2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

KËRKESË

Shtetasja Katerina Mico, e datëlindjes 19.8.1962, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë shpalljen të zhdukur të babait të saj, shtetasit Kita Mico, i datëlindjes 22.9.1935, si dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pronave të tij.

KËRKUESE
Katerina Mico

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 504 lekë